

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



PUNIM MAGJISTRATURE

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018  
dhe lufta kundër tij”

Mentor:

Prof.Dr. Besa Arifi

Kandidat:

Arbana Reshiti

Tetovë, 2020

## DEKLARATË

Unë Arbana Reshiti, e nënshkruar deklaroj që:

- Ky punim përfaqëson punimin tim original, përveç rasteve të citimeve dhe referencave, duke shmangur çdo formë të plagjiaturës dhe duke respektuar rregullat e shkrimit akademik për kërkime shkencore;
- Të dhënat e përdorura në këtë punim janë siguruar nga institucione të specializuara në përgaditjen e të dhënave;
- Ky punim nuk është përdorur më parë si punim magjistrature në këtë universitet apo në universitete të tjera.

---

Arbana Reshiti

## FALEMINDERIME DHE DEDIKIME

Ky punim është realizuar falë Zotit, i cili më mundësoi shëndetin, suksesin dhe besimin që mund të arrija gjithçka në jetë, jam pa fund faleminderuese dhe mirënjohëse ndaj familjes sime për kurajon dhe mbështetjen që më kanë ofruar gjithmonë në rrugën e gjatë të arsimimit e veçanërisht faleminderoj nënën e cila ishte muza ime gjatë këtij rrugëtimi. E lumtur që arrita të realizoj edhe këtë qëllim të jetës sime, dua të faleminderoj të gjithë stafin e Fakultetit Juridik pranë Unviersitetit të Evropës Juglindore, të cilët me një punë të palodhur na ndihmuan shumë për plotësimin e të gjitha detyrave e detyrimeve që një studim master kërkon.

Për realizimin e këtij punimi faleminderoj për zemërsisht profesoreshën Besa Arifi e cila me sygjerimet dhe këshillat e saj ndihmoi në kontinuitet përfundimin me sukses të këtij punimi. Nuk e zgjodha rastësisht mentore profesoreshë Besën, ajo gjithmon me diturinë dhe urtësinë e saj më ka bërë që t’i pres me padurim ligjeratat e saj dhe ta kem të preferuarën time, e admiroj suksesin e saj, e faleminderoj për përkushtimin dhe i jam thellësisht mirënjohëse.

## ABSTRAKT

Korrupsioni ka një varg të gjerë të efekteve të dëmshme për shoqërinë. Ai dëmton rëndë demokracinë dhe sundimin e ligjit, kërcënon cilësinë e jetës, mund të shkaktojë paraqitjen e krimet të rëndë dhe kërcënon sigurinë e të gjithë komunitetit shoqëror.

Lufta kundër korrupsionit nuk është proces i thjeshtë, por nënkupton angazhim të të gjithë komunitetit shoqërorë dhe nismë në të gjitha nivelet. Çdo individ ka obligim moral dhe ligjor të luftojë kundër korrupsionit. Kjo do të thotë jo vetëm njohjen e korrupsionit dhe përmbajtje nga aktet korruptive, por edhe raportimin e rasteve të korrupsionit.

Në kuptim më të gjërë të fjalës, korrupsioni është shpërdorim i pushtetit të besuar për qëllime private. Kjo do të thotë që kur ekziston korrupsioni, ushtrimi i kompetencave publike dhe punëve në interes publik fitojnë karakter të shërbimeve të disponueshme vetëm për ata qytetarë që kanë mundësi të paguajnë të njejtat. Individët të cilët sillen në mënyrë korruptive, nëpërmjet shpërdorimit të kompetencave që ushtrojnë, fitojnë të mira materiale ose jomateriale (për shembull, përfitime të caktuara), të cilat mund të jenë të dedikuara për ta ose për dikë tjetër. Në këtë mënyrë, disa individë përfitojnë në mënyrë të paligjshme, përderisa të tjerëve u është vështirësuar realizimi i ndonjë të drejte e cila u takon. Të dy palët në marrëdhënie mund përfitojnë nga korrupsioni, ndërsa dëmi ndjehet si pasojë në komunitetin më të gjërë shoqëror.

Me anë të këtij studimi do të mundohemi të shpalosim të gjitha rastet në lidhje me korrupsionin në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën e viteve 2010-2018.

**Fjalë kyçe:** korrupsioni, ligjet, vepër penale, parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit.

## PËRMBAJTJE

Hyrje .....	7
Qëllimet e hulumtimit .....	9
Hipoteza .....	9
Rëndësia e punimit .....	9
KAPITULLI I .....	10
I. KORRUPSIONI, FENOMEN I LASHTË .....	10
1. Kuptimi i nocionit korrupsion .....	10
1.1. Përkufizimi juridiko-penal i korrupsionit .....	12
1.2. Përkufizimi kriminologjik i korrupsionit .....	12
1.3. Përkufizimi ekonomik dhe politik i korrupsionit .....	12
2. Zanafilla e korrupsionit .....	15
2.1. Lulëzimi i korrupsionit në Republikën e Maqedonisë .....	23
3. Korniza juridike e Republikës së Maqedonisë .....	24
4. Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe Institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë, aktorë kryesorë në luftën kundër korrupsionit .....	28
5. Korniza ndërkombëtare .....	31
5.1. Konventa penale për parandalimin e korrupsionit .....	31
5.2. Konventa Civile për parandalimin e korrupsionit .....	31
5.3. Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit .....	32
KAPITULLI II .....	33
II. FORMAT, SHKAQET DHE PASOJAT E KORRUPSIONIT .....	33
1. Format e korrupsionit të pranishme në sistemin e administrimit të drejtësisë në Republikën e Maqedonisë .....	33
1.1. Ndërvarësia midis korrupsionit dhe pastrimit të parave .....	38
2. Mënyrat dhe llojet e korrupsionit .....	39
2.1. Mënyrat e korrupsionit .....	39
2.2. Llojet e korrupsionit .....	39
2.2.1. Korrupsioni sistematik kundrejt atij sporadik .....	39
2.2.2. Korrupsioni funksional kundrejt atij jofunksional .....	39
2.2.3. Korrupsioni në sektorin publik kundrejt sektorit privat .....	39
2.2.4. Korrupsioni aktiv kundrejt korrupsionit pasiv .....	40

2.2.5. Korrupsioni i zi, gri dhe i bardhë .....	40
3. Shkaqet e korrupsionit .....	41
4. Format e korrupsionit më të përhapura në Republikën e Maqedonisë së Veriut (të dhëna nga anketimi) .....	42
5. Pasojat e korrupsionit.....	43
KAPITULLI III.....	47
III. PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KORRUPSIONIT .....	47
1. Komponentët e politikave antikorrupsion.....	47
2. Përkufizimi i tipareve të politikave antikorrupsion.....	48
3. Metodrat për të parandaluar korrupsionin .....	49
4. Besimi publik në sistemin e drejtësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	52
4.1. Denoncimi dhe hetimi penal i rasteve .....	52
4.1.1. Pozita dhe kompetencat e Prokurorisë Publike .....	52
4.1.1.1. Pozita.....	52
4.1.1.2. Kompetenca .....	53
5. Disa raste konkrete të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë për periudhën kohore 2010-2018.....	55
6. Cikli i jetës së mekanizmave të raportimit të korrupsionit.....	60
7. Mjedisi i korrupsionit.....	62
KAPITULLI IV .....	64
IV. Korrupsioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës 2010-2018 .....	64
1. Indeksi i korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën e viteve 2010-2018.....	64
2. Shkaqet që kontribuojnë në përhapjen e korrupsionit në vendet në tranzicion, me theks të posaçëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut (rezultate nga anketimi) .....	66
3. Lëvizja e korrupsionit në për periudhë 2010-2018 në vendet fqinje në tranzicion në krahasim me Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	72
Konkluzioni.....	78
Rekomandimet .....	78
Përfundim.....	80
Lista e shkurtesave .....	82
Lista e grafikoneve.....	83
Literatura e shfrytëzuar .....	84

## Hyrje

Korrupsioni paraqet një problematikë të ndërlikuar dhe voluminoze. Lënda e këtij hulumtimi është studimi, analizimi dhe shqyrtimi i Kushtetutës së RM-së me theks të veçantë Kodit penal si dhe ligjet e tjera sipas rregulloreve dhe neneve të parapara me ligj, për të luftuar korrupsionin dhe përgjegjësinë e personave që janë të punësuar nëpër organet dhe institucionet shtetërore, institucionet tjera të cilët janë edhe përgjegjësit kryesor për këtë fenomen apo dukuri në shoqërinë tonë.

Korrupsioni është një e keqe shoqërore dhe politike me rrënjë shumë të forta, andaj edhe lufta kundër tij është shumë e vështirë dhe e përbërë. Në botën moderne në demokracinë parlamentare dhe kapitalizmin që tashmë kanë marrë karakter global, korrupsioni perceptohet si braktisje e interesit publik në emër të interesit privat. Për këtë dukuri ka përkufizime të shumta dhe të ndryshme, mirëpo me një përkufizim të përbashkët korrupsionin mund ta definojmë si keqpërdorim i detyrës zyrtare për interesa personale, grupe, apo thyerje të rregullave dhe ligjeve për përfitime. Korrupsioni është një fenomen, veçanërisht i shteteve dhe vendeve në zhvillim si dhe karakteristikë e atyre që sapo kanë hedhur pas të shkuarën autoritariste apo sistemin totalitar.

Ky studim ofron një vështrim të përgjithshëm të konkluzioneve kryesore të rishikimit horizontal dhe vertikal të sistemeve të antikorrupsionit në RM nga viti 2010-2018, kuptohet duke i shfletuar të dhënat nëpër institucionet e shtetit dhe duke i rishikuar sipas Kodit Penal se si janë ndëshkuar personat e korruptuar dhe arsytet e lindjes së këtij fenomeni apo dukurie në shoqëri. Pra, lënda e këtij studimi është çështja se si korrupsioni duhet të luftohet dhe nuk vihet fare në dyshim se organet kompetente janë bartësit kryesor të korrupsionit dhe se kostoja e korrupsionit është tepër e lartë në kuptimin ekonomik dhe sociale dhe se mund të dëmtojë edhe të drejtat dhe lirinë e individit.

Kështu që, fusha e parë funksionale e këtij studimi është shqyrtuar duke u bazuar në politikat antikorrupsion dhe aktivitetet e saj përgatitore. Në vitet e fundit, kur politika antikorrupsion dhe korniza legjislativë në RM-së, ka kaluar nëpër disa ndryshime përsëritëse, shpesh si konsekuencë e konkurrencës institucionale sesa e kapacitetit të rritur institucional. Ngase po të shikojmë drejt fazës së ardhshme të zhvillimit me indiferencë, strategjia e luftës kundër korrupsionit sigurisht se do të përfitonte nga një qasje më pjesëmarrëse në politikë bërje, duke u mbështetur në konsultime të gjera, brenda dhe jashtë administratës. Gjithashtu, edhe korniza ligjore duhet të

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

rishikohet, me qëllim që ajo të bëhet më pak e fragmentuar dhe të ketë qasje më të madhe ligji në fuqi, kundër korrupsionit.

**Me anë të këtij punimi do mundohemi t'i sqarojmë çështjet e mëposhtme kërkimore:**

- Definimi i korrupsionit;
- Format, shkaqet dhe pasojat e korrupsionit;
- Si të parandalohet dhe luftohet korrupsioni;
- Besimi publik në sistemin e drejtësisë në Maqedoni;
- Analizë e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 2010-2018, gjithashtu analizë e politikave dhe strategjive shtetërore kundër tij.



## Qëllimet e hulumtimit

Qëllimet e këtij hulumtimi janë shumë dimenzionale dhe komplekse. Qëllimi primar është që botës akademike dhe popullatës në RM-së t'i jepet një kontribut për zhvillimin, funksionimin dhe esencën e Kodit penal, me theks të veçantë luftës kundër korrupsionit, si një fenomen që ka hyrë në poret e vendeve, sidomos të vendeve në tranzicion. Esenca e studimit konsiston në analizën e pozitës së këtij fenomeni në raport me përgjegjësinë që e kanë institucionet përgjegjëse të RM-së.

## Hipoteza

Në punim do të parashikohen edhe tezat për ndërtimin e sistemit që përmban në vete përgjegjësia e njerëzve kompetent në ushtrimin e detyrës antikorupsion të emruar nga shteti. Dhe atë:

*Hipoteza 0 ( $H_0$ ):* Politikat dhe strategjitë shtetërore të Republikës së Maqedonisë kundër korrupsionit kanë ndikuar në uljen e tij;

*Hipoteza A ( $H_A$ ):* Politikat dhe strategjitë shtetërore të Republikës së Maqedonisë kundër korrupsionit nuk kanë ndikuar në uljen e tij.

## Rëndësia e punimit

Punimi do të paraqet kontribut të veçantë për disa aspekte:

- Së pari, do mund të shfrytëzohet si bazë e mirë e të dhënave për studentët dhe qytetarët;
- Së dyti, do të paraqet mundësi për analizë dhe studim për studentët si edhe njohje për qytetarët;
- Së treti, punimi mund t'u shërbej institucioneve përgjegjëse që janë në luftë me korrupsionin, pra do t'i orientoj kah objektivi korrupsion.

## KAPITULLI I

### I. KORRUPSIONI, FENOMEN I LASHTË

#### 1. Kuptimi i nocionit korrupsion

**Korrupsioni** mund të përkufizohet si devijim nga morali, nderi dhe detyra qytetare. Sjelljet e korruptuara ngërthejnë në vete ato veprime, të cilat qëllimisht nuk i përfillin normat e imponuara nga shoqëria për të siguruar funksionimin normal të sferës ekonomike, politike dhe shoqërore të shoqërisë në tërësi.<sup>1</sup>

Me një fjalë, korrupsioni mund të trajtohet si shthurje e rregullave të lojës.<sup>2</sup>

Sipas parimit të ligjshmërisë, me termin korrupsion kuptojmë shmangie nga normat ligjore dhe formale të sjelljes zyrtare.<sup>3</sup>

Në shumë ligje të së drejtës penale, korrupsioni përkufizohet si marrje e përfitimit privat nga një punonjës publik për një veprim zyrtar.

Prandaj, korrupsioni mund të kuptohet si një shtrembërim patologjik i detyrimeve, normave dhe si i tillë është një dukuri që mund të kurohet nëpërmjet edukimit të përgjithshëm, fushatave, arsimimit profesional të organizuar dhe zhvillimit të një ndershmërie ndaj interesave shoqërore, duke u mbështetur në vlera ‘idiologjike’, mandej edhe në ato ‘ekstatologjike’. Një numër i madh i shkenctarëve kanë një përkufizim për korrupsionin, ku sipas tyre, korrupsioni është një sjellje që devijon nga detyrat normale të rolit publik që favorizon privatisisht ata që janë pjestarë të familjes, antarë të një klinike të mbyllur private dhe që kërkon përfitime në para ose në status që dhunojnë rregullat kundër ushtrimit të disa llojeve të caktuara të ngufatjes personale.<sup>4</sup>

**Korrupsioni paraqet sëmundje të rëndë shoqërore, e cila shkakton vdekjen e qeverive të mirëfillta, mosfunksionim të shoqërisë dhe vuajtje të njerëzve nga pasiguria dhe mosbesimi në institucione.<sup>5</sup>**

---

<sup>1</sup> Monica Masoveci, Tiranë 1994, fq.256

<sup>2</sup> Veselin Vukotic, Beograd 2000, fq.15

<sup>3</sup> Josip Krega, Tiranë 1994, fq.32

<sup>4</sup> Joseph Nye, Tiranë 1994, fq.50

<sup>5</sup> Vetë autori

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

**Rregullorja në Republikën e Maqedonisë e definon korrupsionin si:** "Përdorimi i funksionit, autoritetit publik, detyrës zyrtare dhe pozitës për të arritur ndonjë lloj dobie për veten ose për të tjerët".<sup>6</sup>

Ekziston një numër i madh i definicioneve për korrupsionin si një dukuri që e hasim në çdo vend, por me intezitet të ndryshëm.

Korrupsioni duke qenë i ndërlidhur me ekonominë, biznesin, tenderimet, jetën politike etj, ndikon drejtpërdrejt edhe në paraqitjen e tronditjeve shoqërore dhe të krizave të ndryshme qeveritare. Ai shkakton ngecje në zhvillimin ekonomik, në reforma politike e institucionale, pengesa e vështirësi në integrimin e vendit në organizata e institucione ndërkombëtare, antipati ndaj shtetit të tillë “problematikë” etj. Në fakt, korrupsioni, sidomos kur me të merren personat që ushtrojnë funksione të larta publike, shkakton edhe humbje të shpresës së qytetarëve lidhur me perspektivën e tyre dhe të vendit, sepse krijohet përshtypja se ai është i pamposhtur.

Përkufizimi i korrupsionit është një detyrë e vështirë. Ai është një fenomen kompleks që përfshin një gamë të gjerë praktikash, nga ryshfeti individual deri tek vjedhja apo shpërdorimi i madh i fondeve publike.

**Sipas Transparency International,** korrupsioni përkufizohet si “abuzim me pushtetin e besuar për përfitime private”.

**K = P1 + P2 – LI** K=Korrupsion P1=Përfitim P2=Pushtet LI=Llogaridhënie

**Transparenca** mund të përkufizohet si një parim i cili bën të mundur që personat e prekur nga vendimet administrative, transaksionet e biznesit apo veprat e bamirësisë të njihen jo vetëm me faktet dhe shifrat por edhe me mekanizmat dhe proceset.

Çdo qytetar duhet të përpiqet që transparenca të mbizotërojë në të gjitha sferat e shoqërisë, si publike ashtu edhe private.

**Llogaridhënia** e personave apo institucioneve ekziston atëherë kur detyrat e tyre profesionale i “nënshtrohen mbikqyrjes, drejtimit apo kërkesës së të tjerëve për të dhënë informacion apo për të justifikuar veprimet e tyre.” Niveli i lartë i llogaridhënies ndihmon në minimizimin e mundësive për korrupsion.

---

<sup>6</sup> Neni 1-a i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit - teksti i pastruar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 28/02, 04 / 04,126 / 06, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të datës 10.01.2007, 10/08, 161/08)

**Integriteti** i sjelljes dhe veprimeve në përputhje me një tërësi parimesh e standardesh morale apo etike që zbatohen nga individët e institucionet dhe që pengojnë korrupsionin.

Në formë ekuacioni, korrupsioni do të ishte i tillë: *Ekuacioni tregon se korrupsioni rritet kur rriten mundësia për përfitim dhe pushteti. Ndërsa, korrupsioni zvogëlohet kur individët japin llogari për veprimet e tyre.*<sup>7</sup>

### **1.1. Përkufizimi juridiko-penal i korrupsionit**

Përkufizimi juridik i korrupsionit është ndërtuar si shkelje e ndonjë norme-shoqërore, morale, administrative dhe penale.

Në kuptimin penal-juridik, korrupsioni përfshin inkriminimin në rryshfet pasiv dhe rryshfet aktiv, ndërmjetësimin e kundërligjshëm dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare, për arritjen e përfitimeve personale për vete ose për tjetrin.<sup>8</sup>

Ligji për pengimin e korrupsionit në RMV, korrupsionin e përkufizon si shfrytëzim i funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare dhe autorizimin me qëllim të shfrytëzimit të çfarëdo fitimi për vete apo për tjetrin. Definimi i korrupsionit në RMV në aspektin legjislativ për herë të parë është në vitin 2004 me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për pengimin e korrupsionit.<sup>9</sup>

### **1.2. Përkufizimi kriminologjik i korrupsionit**

Në kuadrin e ideve dhe mendimeve të shumta lidhur me detyrat e kriminologjisë, dallojmë dy grupe që janë:

- tradicionale - sipas të cilave detyra e kriminologjisë është zbulimi i shkaqeve të fenomenit krim, dhe
- botëkuptimi modern, sipas të cilit kriminologjia duhet të orientohet më tepër në çështjen e reagimit shoqëror ndaj kriminalitetit.<sup>10</sup>

### **1.3. Përkufizimi ekonomik dhe politik i korrupsionit**

Ekonomistët korrupsionin e përkufizojnë si një gjendje në të cilën të mirat publike, shërbimi publik dhe detyra zyrtare “shiten” me qëllim të realizimit të fitimit personal ose si një eksploatim

<sup>7</sup> <http://idmalbania.org/ep-content/uploads/2016/01/Broshure-AntiKorrupsioni.pdf>

<sup>8</sup> Vlado Kamboski&Petar Naumovski, Korrupcijata najgolemo opshtesveno zlo i zakana za pravkata drzhava, Shkup 2002 fq.24

<sup>9</sup> Gazeta zyrtare e RMV-së, nr.46/2004

<sup>10</sup> Alisabri Shabani, Muhamed Budimilic, përktheu nga kroatishtja prof.Mustafë Reçica, Sarajevë/Prishtinë 2007, fq.7

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

të qirasë ekonomike e cila buron nga pozita monopoliste e personave zyrtarë, ku korrupsioni mbase e siguron çmimin edhe atje ku nuk funksionon tregu me ligjshmëritë e tij.<sup>11</sup>

Korrupsioni politik i cënon bazat e tjera të shtetit të së drejtës, si: parimin e ligjshmërisë, mosdiskriminimin dhe barazinë e qytetarëve, zgjedhjet e lira, ushtrimin e funksioneve publike në interes të përgjithshëm shtetëror, gjyqësinë e pavarur, si dhe vetë ligjitimitetin dhe legalitetin e pushtetit shtetëror.<sup>12</sup>

### **Në bazë të ligjit për parandalimin e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut:**

Korrupsioni në politik mund të jetë prezent gjatë kohës së zgjedhjeve si dhe pas tyre, por gjithashtu mund të jetë prezente edhe në mungesë të zgjedhjeve, gjatë veprimtarisë së partive politike. Në këtë drejtim është e rëndësishme ndalesa e aktiviteteve të partive politike, sindikateve dhe shoqatat e qytetarëve të finansohen nga fondet e buxheteve të njësisve të vetëqeverisjes lokale. Gjatë kohës së zgjedhjeve presidenciale, parlamentare ose lokale nuk është lejuar të përdoren mjetet e buxhetit të komunave dhe të qytetit deri në përfundimin e tyre, që do të thotë se:

- Është i ndaluar fillimi i ndërtimit të objekteve në infrastrukturë prej mjeteve buxhetore të komunave, siç janë: rrugë, ujësjellës, linjë elektrike, kanalizime dhe të ngjajshme, si dhe objekte për aktivitete shoqërore, siç janë foshnjoret dhe shkollat. Ndalesa nuk vlen vetëm në rast se mjetet buxhetore kanë qenë të siguruara më herët, gjegjësisht kur ndërtimi është pjesë e programit që në bazë të ligjit është sjellë në vitin aktual.
- Mjetet buxhetore nuk mund të përdoren për pagesa urgjente të pagave, pensioneve, ndihmës sociale dhe pagesa të tjera, ndërsa është e ndaluar edhe shitja e kapitalit shtetëror si dhe firmosja e marrëveshjeve kolektive gjatë kohës së zgjedhjeve.

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit mban llogari për respektimin e ndalesave. Në afat prej tre muajve prej ditës së përfundimit të zgjedhjeve, Komisioni i dorëzon Kuvendit raport të posaçëm për keqpërdorimet e mundshme të mjeteve buxhetore. Raporti publikohet edhe në media për informim të publikut. Personat zyrtarë të cilët veprojnë në kundërshtim të këtyre ndalesave përgjigjen për kundërvajtje, që do të thotë se do të jenë të dënuar me gjoba prej 1000 deri më 2000 euro në kundërvlerë të denarit. Nëse vërtetohet se ekziston një shkallë më e lartë e përgjegjësisë ose është shkaktuar dëm më i madh material, dënimi mund të dyfishohet. Pas

<sup>11</sup> Vlado Kambovski dhe Petar Naumovski, fq.24

<sup>12</sup> Vlado Kambovski dhe Petar Naumovski, fq.24

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

përfundimit të zgjedhjeve, është e ndaluar firmosja e kontratave, prokurimit dhe marrëveshjet tjera mes organeve të vetëqeverisjes lokale dhe personave juridik vendas apo të huaj që sjellin fitim, me anë të së cilave kryhet privilegjim ose diskriminim. Gjithashtu nuk guxon që me anë të Udhëzues për ndalimin e korrupsionit në vetqeverisjen lokale lejeve, konçesioneve ose vendimeve të ndryshme, disa subjekteve juridike të caktuar tu pranohet ose mohohet e drejta ose privilegjet të parashikuara me ligj.

Në të dy rastet, Komisioni shtetëror do të ndërmer masat përkatëse.<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup> <http://myla.org.mk/ep-content/uploads/2018/01/ALB-brosura-90x140-za-PRINT.pdf>

## 2. Zanafilla e korrupsionit

Korrupsioni është një fenomen i cili ka ekzistuar që në lashtësi, sidomos me formimin e shtetit.

Korrupsioni ka qenë një fenomen i përhapur dhe i përsëritur gjatë historisë njerëzore. Ai ka qenë i pranishëm në të gjitha sistemet politiko-shoqërore, në nivele dhe forma të ndryshme.

**Kodi Hammurabi i shekullit 18 p.e.r.** specifikon masa ndëshkimore të bazuara ligjërisht kundër nëpunësve të korruptuar, veçanërisht për korrupsionin e gjyqtarëve.

Në **shekullin 4 p.e.r.**, Kaulitiliya, Kryeminisër i Mbretërisë së Indisë, ka shkruar librin Arathasastra në të cilin ka diskutuar edhe korrupsionin.

**Aristoteli, Platoni, Tuqidhidhi, Makiavelli dhe Rusoi** e kanë studuar korrupsionin shtetëror.

**Dante** i ka vendosur mitëmarrësit në rrethin më të thellë të ferrit, duke pasqyruar neverinë mesjetare për njerëzit e korruptuar.

**Shekspiri** i ka dhënë korrupsionit një vend të spikatur në disa nga veprat e tij.

**Kushtetuta e Amerikës** e vlerëson rryshfetin si një krim të qartë, i cili justifikon fajësimin e Presidentit të Amerikës. Politikanë të njohur (presidentë, kryeministra, ministra) i kanë humbur pozitën e tyre për shkak të korrupsionit dhe, në disa raste të rralla, klasa politike është zëvendësuar tërësisht.<sup>14</sup>

Në **arkivat e Babilonisë së vjetër, në shekullin 24-ër para erës së re** përmendet korrupsioni në sistemin e shërbimeve shtetërore gjatë epokës së Sumerëve dhe Semiteve.

Një minimum korrupsioni, theksonte **Winston Churchill**, shërben si vaj lubrifikues i mirë për makinerinë e demokracisë. Shtetasi i madh britanik, me alternim të mençur, dinte të distilonte retorikën për momentet e vështira dhe cinizmin për ato më pak të vështira. Padyshim dhe larg çdo klisheje të zakonshme, mund të thuhet fare mirë se një minimum korrupsioni – në një shtet që nuk është totalitar dhe kontrollues maniakal i jetës së qytetarëve – është fiziologjik. Sigurisht që natyra njerëzore nuk ndryshon më vendim qeverie.

Korrupsioni, sidomos ai politik, zbret poshtë në origjinën e njerëzimit dhe gjeti terren pjellor në Romën e lashtë. Dhe me Romë të lashtë nënkuptojmë si atë republikane, ashtu edhe atë perandorake.

<sup>14</sup> <http://shtetiweb.org/2018/10/31/indikatore-t-e-zbulimit-te/>

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

Në kodifikimin e ligjeve të Perandorisë Romake takojmë një formulim të veçantë për korrupsionin ku me korrupsion identifikohet personifikimi i së keqes çka tregonte dhe qëndrimin negative të opinionit publik romak të kësaj dukurie.

**Ciceroni** në veprën e tij: Mbi shtetin si dhe në fjalimet e tij publike shpeshherë ka trajtuar problemet që lidheshin me marrjen dhe dhënien e ryshfeteve nga nëpunësit e shtetit, ku natyrën e korrupsionit e shikonte te qenia dhe vetëdija e njeriut dhe prania e veseve njerëzore. Në të drejtën Romake për herë të parë ndeshim një ligj të përpiluar posaçërisht për korrupsionin poashtu edhe vetë prejardhja e fjalës korrupsion e ka origjinën nga latinishtja. Me fjalën **“Corruptire”** kuptoheshin sinonime të fjalëve: prish, shkatrojt, dëmtoj, falsifikoj, jap dhe marr rryshfet, korruptoj. Ndërsa, në Greqinë antike në vend të fjalës korrupsion përdorej fjala **“kataliz”** (katalysis) që kishte kuptim shkatrojt, shfaros.<sup>15</sup>

Korrupsioni është një aktivitet djallëzor që shkaktohet nga mangësi psiko–sociale të normave të sjelljes së njerëzve, i cili synon të prodhojë avantazhe ose përfitime të jashtëligjshme për veten, për familjen ose për miqtë, shokët ose për aleatët politikë. Shkak kryesor i korrupsionit është tundimi.

Korrupsioni është një koncept me shumë kuptime ose një bashkësi konceptesh njëkuptimore, të cilët bëjnë pjesë në shkencat ekonomike, politike, psikologjike dhe matematike. Deri më sot nuk është zbuluar njësia matëse e korrupsionit. Në kuptimin popullor, korrupsioni është shpërdorim i pozitës shtetërore për të siguruar përfitime joshtetërore.

Katalogu i aktiviteteve korruptive përmban ryshfetin, kërcënimin, ushtrimin e ndikimit, përvehtësimin e pronës ose pasurisë së tjetrit, shpejtimin ose ngadalësimin e qëllimshëm të kryerjes së punës ose favorizimin duke paguar para, mashtrimin, nxjerrjen në shesh të informacioneve sekrete ose konfidenciale, nepotizmin, etj.

Korrupsioni ekziston jo vetëm në institucione shtetërore të niveleve të ndryshme por edhe në sektorin privat dhe në organizata ndërkombëtare.

Një aktivitet njerëzor, pavarësisht nëse ai është shtetëror, privat ose jofitimprurës, pavarësisht nëse ai zhvillohet në Amerikë, Itali, Japoni, Rusi apo Shqipëri, ka prirje të bëhet aktivitet i korruptuar në qoftë se një person (ose një grup njerëzish) ka monopolizuar fuqinë mbi një mall ose shërbim, gëzon lirinë e gjykimit dhe të veprimit për të vendosur ofertën dhe çmimin e këtij malli ose shërbimi dhe ky person (ose grup njerëzish) nuk i jep llogari askujt (nuk mban

---

<sup>15</sup> Luan Gjonça, Korrupsioni, Tiranë 2004, fq.20



përgjegjësi) për zhvillimin e aktivitetit. **Pra, në kuptimin metaforik, korrupsioni shprehet me formulën Klitgaard-Kolaneci:**

$K = M + L - P$ , ku

- K tregon korrupsionin;
- M tregon monopolizimin e fuqisë;
- L tregon lirinë e gjykimit dhe veprimet;
- ndërsa P tregon përgjegjësinë.

Përmirësimi i qeverisjes është thelbësor për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për përmirësimin e nivelit të jetesës së njerëzve të varfër. Por, të dyja këto objektiva kryesore kërcënohen nga korrupsioni. Programet dhe strategjia e qeverisjes së mirë kanë komponent kryesor strategjinë antikorrupsion. Asnjëherë nuk duhet nënvlerësuar nevoja urgjente që ka korrupsioni për mbështetje nga forca politike. Korrupsioni ndihmohet dhe nxitet edhe nga qëndrimi i gjatë në pushtet i së njëjtës partie politike.

Shkencëtarë të shquar në teorinë e korrupsionit (**S. Rose-Ackerman, R.E. Klitgaard, etj.**) kanë argumentuar se “në shtete në tranzicion, me institucione politike dhe administrata relativisht të dobta, korrupsioni shndërrohet në një sistem”, në kuptimin e Analizës Sistemore të Aplikuar. Kjo do të thotë se sistemi i korrupsionit funksionon si një i tërë dhe përbëhet nga disa nënsisteme që bashkëveprojnë midis tyre, në përputhje me vendimet e marra nga organi drejtues i këtij sistemi. Rrjedhimisht, sistemi i korrupsionit duhet të luftohet me anën e sistemit të antikorrupsionit.

Një rast tipik i studiuar nga **Profesori R.E. Klitgaard** është korrupsioni sistemor në shtete në tranzicion, kur partia në pushtet dhe partia opozitare kryesore janë përkohësisht të pafuqishme për të fituar luftën kundër disa liderëve dhe biznesmenëve të korruptuar. Ky rast tipik paraqet interes studimi edhe për Maqedoninë.

Kur institucionet shtetërore vuajnë nga “sëmundja” e quajtur “korrupsion sistemor”, shumica e popullit pëson humbje, ndërkohë që politikanë të korruptuar, biznesmenë të korruptuar dhe nëpunës shtetërorë të korruptuar sigurojnë fitime shumë të mëdha. Korrupsioni sistemor ka dy komponentë: korrupsionin e centralizuar dhe atë të decentralizuar, ndër të cilët komponenti i parë është kryesor.

Strategjia e sistemit antikorrupsion fokusohet në sistemin e korrupsionit dhe jo vetëm në individë të korruptuar. Në vend që të mendohet se lufta kundër sistemit të korrupsionit përqëndrohet

vetëm në individë imoralë të cilët nuk respektojnë ligjet e shtetit dhe besimin që u është dhënë, ne duhet të mendojmë se kjo luftë duhet të ketë objektiv kryesor sisteme të cilat janë të prekshme dhe të dyshueshme nga disa aktivitete të ndaluara (për shembull, sistemi doganor, sistemi i tatim-taksave, sistemi i drejtësisë, sistemi i arsimit, sistemi i shëndetësisë, sistemi bankar, etj).

Indikatorët e korrupsionit nuk janë evidentë. Ata japin kontribute të ndryshme në zbulimin dhe ndëshkimin e aktiviteteve korruptive, në kuptimin që disa prej këtyre indikatorëve janë më të rëndësishëm se të tjerët. Në qoftë se këta indikatorë ndodhin në mënyrë të përsëritur ose të kombinuar me njëri-tjetrin, atëherë ndihmojnë jo vetëm në rritjen e dyshimit por ndoshta edhe në fillimin e procedurave të ndjekjes penale ndaj nëpunësit shtetëror të akuzuar për korrupsion.

Në cilindo kontroll antikorrupsion nuk duhet të përdoret me paramendim një nënbashkësi e bashkësisë së indikatorëve të korrupsionit, sepse mund të zvogëlohet niveli real i aktivitetit korruptiv.

Ekzistojnë dy lloje indikatorësh të korrupsionit: indikatorë neutral dhe indikatorë specifik.

### **Indikatorët Neutral të Korrupsionit**

Indikatorët neutral shqyrtohen në lidhje me qëndrimin dhe sjelljen personale të nëpunësit shtetëror në punë dhe jashtë saj. Këta indikatorë janë konsideruar të pranueshëm edhe nga opinioni shoqëror. Indikatorët netutral të vrojtuar më dendur në aktivitete korruptive gjatë tri dekadave të fundit në shtete të ndryshme të botës janë këta:

1. Pasurim i madh dhe i paargumentuar në mënyrë të ligjshme, ndryshim i pashpjegueshëm i nivelit të jetesës, mënyrë jetese luksoze, e cila nuk mund të sigurohet me të ardhurat familjare ose personale. Për shembull, ndërtime ose blerje e një vile, blerje e një vile të dytë ose apartamenti në bregdet, blerje e një veture të shtrenjtë, shpenzime të tepruara për veshje, për pushime dhe për argëtime të ndryshme, veçanërisht në lojrat e fatit, etj;
2. Probleme sociale apo personale, të tilla si nepotizëm, varësi e theksuar ose detyrime ndaj një personi tjetër;
3. Punësim i dytë jashtë institucionit, i cili është shumë i afërt në kuptim kritik me detyrën shtetërore (dmth, në kundërshtim me interesat e institucionit);
4. Pranime ftesash të ndryshme nga biznesmenë për pushime fundjave në vila ose hotele luksoze, dreka ose darka në lokale të shtrenjta, vizita private në kompani ose firma të ndryshme ose në panairë tregëtare, etj;

5. Pranime marrëveshjesh të pazakonshme dhe speciale për blerje sendesh ose shërbimesh, zbritje e theksuar e çmimit të blerjes ose favorizim në periodën e shlyerjes së pagesës;
6. Bujari e tepruar në dërgim dhuratash (bile edhe me adresë shtëpie); zemërgjerësi e shtirur kundrejt shefit;
7. Pjesëmarrje e dendur në takime private me shefa, me propozues ofertash (biznesmenë pjesëmarrës në tendera), pjesëmarrje në evenimente private ose biznesi;
8. I lejon vetes të jetë i domosdoshëm në punë; për shembull, shkon në punë ndonëse është i sëmurë, për të mënjeluar ndodhinë që punonjës të tjerë të njohin në brendësi “marifete” që ai ka kryer;
9. Mashtrues (për shembull, një politikan mashtron në deklarin e pasurisë; një oficer i policisë gjyqësore mashtron duke deformuar faktet e një hetimi);
10. Merr në shtëpi dokumente të rëndësishme të punës;
11. Trajtim i sakt i rasteve tepër të vështira ose delikate, ndonëse nëpunësi nuk ka përgatitje teoriko–shkencore të nevojshme, specializim dhe eksperiencë pune;
12. Vetmi e pashpjegueshme; fjalëpak me eprorët dhe kolegët;
13. Ndryshim i menjëhershëm dhe i pashpjegueshëm i opinionit vetiak; për shembull, duke e mbështetur një projekt, të cilin më parë e kishte kundërshtuar;
14. Refuzim i paargumentuar për të bërë rivlerësimin ose çuarje përpara të punëve, veçanërisht kur këto kanë të bëjnë me përmirësime teknike, teknologjike ose metodologjike;
15. Mungesë pakënaqësish ose konfliktesh në raste kur këto janë të zakonshme ose të pritshme;
16. Ton zëri i pazakontë ose i shkujdesur me shefa ose me vartës ose me publikun.

### **Indikatorët Specifik të Korrupsionit**

Në ndryshimin nga indikatorët që janë neutral ndaj korrupsionit, indikatorët specifik të korrupsionit duhet të konsiderohen si sinjale ose shenja paralajmëruese, të cilat duhet të çojnë në rritjen e dyshimit për ekzistencën e parregullsive ose të shkeljeve ligjore. Përvoja e korrupsionit në shtete të ndryshme të botës gjatë dekadave të fundit sugjeron se indikatorët specifikë të konstatuar më dendur në aktivitete korruptive janë këta:

1. Vendime të pashpjegueshme të cilat nuk janë marrë më parë në mënyrë të tillë;
2. Vlerësime ose trajtime të ndryshme të rasteve që kanë të dhëna ose fakte të njëjta;
3. Shpërdorim ose interpretim i njëanshëm i fuqisë vetiake të lirisë së gjykimit ose të veprimit;

4. Moskryerje kontrollesh ose revizionimesh, ndonëse ka shkaqe të arsyeshme për kryerjen e tyre;
5. Manipulim i trajtimit të një rasti, i cili është studiuar dhe vlerësuar më parë nga nëpunës të tjerë brenda institucionit;
6. Parakalim i kompetencave të eprorëve në raste kritike dhe shtrirje e papranueshme e fuqisë ligjore të ngarkuar;
7. Praktikë e përsëritur e takimeve jashtë pune, pa ndonjë shpjegim të besueshëm për lidhje të tyre me punën;
8. Preferencë e përsëritur për mbështetjen e disa personave pjesëmarrës në tendera
9. Futja në bisedime për një marrëveshje të pafavorshme për institucionin
10. Butësi e dukshme gjatë bisedave për kontratat
11. Mungesë e dëftesë pagesës për shërbime ose e vulës me orë në korrespondencën zyrtare me pjesëmarrës në tendera ose me kontraktorë;
12. Ankesa nga kontraktorë ose pjesëmarrës në tendera, në të cilat evidentohen parregullsi të procedurave të zbatuara nga nëpunësi shtetëror, veçanërisht në rastet kur këto ankesa nuk janë marrë parasysh nga institucioni shtetëror përkatës;
13. Zhdukje ose fshehje dokumentash të marrjes së vendimeve, të kontratave të rëndësishme ose të inspektimeve të kryera;
14. Nëpunësi shtetëror zhvillon një lojë të pandershme me dy ose më shumë klientë
15. Vizita të rregullta të disa biznesmenëve, kontraktorëve ose klientëve në zyrën e nëpunësit shtetëror;
16. Diskutime të hapura të disa nëpunësve shtetërorë në mjedise konfidenciale, që kanë lidhje me mënyra të vepruari ose sjellje jokorrekte të cilat, në qoftë se do të zbatoheshin, do të sillnin përfitime personale;
17. Tendencë për stërzgjatjen e disa kontrolleve të ushtruara nga nëpunësi shtetëror ose për dhënien e konkluzioneve përkatëse;
18. Shoqërime që bien në sy, madje edhe takime private, të nëpunësit shtetëror me persona kriminelë ose mafiozë ose të korruptuar ose të dënuar;
19. Kundërshtim ose mospërfillje nga ana e nëpunësit shtetëror ndaj dyshimeve të ngritura për disa individë, firma ose kompani;

20. Nxjerrje në shesh në mënyrë të pashpjegueshme e informacioneve sekrete ose konfidenciale nga ana e nëpunësit shtetëror;
21. Miratim i porosisë ose udhëzimit të dhënë nga eprori, që një rast kritik të trajtohet si rast i zakonshëm;
22. Mospërfillje e dyshimeve për zbatim të ligjshmërisë në veprime të kryera më pare;
23. Përshpejtim, ngadalësim ose ndërprerje e paargumentuar e trajtimit të një rasti;
24. Dobësim i kontrollit të brendshëm; përshembull, mbyllje e një seksioni të dobishëm në punë ose lejim i disa nëpunësve që të bëhen të pavarur;
25. Parakalim i tenderave; mungesë larmie në ofertat e tyre;
26. Kërkesë për blerje dhe instalim sistemesh logjistike të teknologjisë së vjetëruar dhe me efektivitet të ulët;
27. Kryerje blerjesh me çmime më të larta se ato që ofron kursi i tregut; dublim i dëftesave të pagesave;
28. Ndryshime të shpeshta dhe gabime aritmetike të qëllimshme në dokumente të kontratave ose tenderave;
29. Njolla korruptive nga e kaluara e nëpunësit shtetëror;
30. Financime të fuqishme (madje edhe të njëkohshme) të disa partive politike kryesore në fushata zgjedhore nga kompani private ose biznesmenë;
31. Pengim i paargumentuar dhe i qëllimshëm nga ana e një pushtetari kryesor i investimeve ose zhvillimit të prodhimit vendas në një fushë të caktuar, sepse cënohen interesa të përfitimit personal ose të ndonjë monopoli.

Në listat e mësipërme janë renditur 16 indikatorë neutral dhe 31 indikatorë specifik të korrupsionit, gjithsej 47 indikatorë.

Indikatorët e korrupsionit përmbajnë fakte reale. Ata nuk janë thjesht supozime ose hipoteza. Prandaj, këta indikatorë kanë forcë investiguese.

Dy faktorë shumë të rëndësishëm të mbijetesës së sistemit të korrupsionit janë mungesa e monitorimit të indikatorëve të korrupsionit dhe mungesa e vullnetit politik për ndëshkimin e aktiviteteve korruptive.

Në qoftë se korrupsioni do të mbahet në nivele të ulta për të gjithë administratën për një periudhë kohore dhjetëvjeçare, atëherë shpresohet të gjenerohet një trajektore e gjendjes së qëndrueshme me nivele të ulta korrupsioni.

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

Mbijetesa e korrupsionit shpeshherë është argumentuar me anën e parimit të reputacionit të keq të brezave:

Të rinjtë trashëgojnë një reputacion të keq nga persona të korrumpuar të moshuar. Për pasojë, një pjesë e brezit të ri ndikohet nga përvoja korruptive e të moshuarve. Një rrjedhim i drejtpërdrejtë i këtij argumentimi është rreziku serioz i korrupsionit të një pjese të konsiderueshme të studentëve në mjedise universitare të infektuar nga korrupsioni. Mund të imagjinohet dëmi kolosal i familjeve dhe i krejt shoqërisë shqiptare, i shkaktuar nga ky lloj korrupsioni.<sup>16</sup>

---

<sup>16</sup> <http://shtetiweb.org/2018/10/31/indikatore-t-e-zbulimit-te/>

## 2.1. Lulëzimi i korrupsionit në Republikën e Maqedonisë

Sipas Barometrit Global të Korrupsionit për vitin 2013 nga Transparency International, korrupsioni është një shqetësim i madh në sektorin publik, ndërsa më shumë se gjysma e familjeve të anketuara konsiderojnë Parlamentin, policët, zyrtarë publikë dhe veçanërisht gjyqësorin dhe partitë politike shumë të korruptuara. Mjedisi i biznesit në Maqedoni është ndikuar negativisht nga korrupsioni. Disa burime tregojnë se korrupsioni është konsideruar si një pengesë për të bërë biznes, dhe biznesmenët kanë raportuar se ryshfeti është kërkuar ndonjëherë gjatë prokurimeve publike dhe kontraktimit.<sup>17</sup> Pas luftës së dytë Botërore Republika e Maqedonisë deri në pavarësinë e saj më 1991 ka qenë pjesë e sistemit juridik të RSFJ-së (Republika socialiste Federative e Jugosllavisë). Në bazë të sistemit juridik jugosllav si veprime korruptive konsideroheshin- keqpërdorimi i pozitës zyrtare, ndërsa pas LDB-së për herë të parë kanë qenë të rregulluara me ligjin për vepra penale kundër keqpërdorimit të detyrës zyrtare. *Me Ligjin penal të vitit 1951 të RSFJ-së janë përcaktuar disa vepra penale kundër detyrës zyrtare: keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit zyrtar, shkelja e ligjit nga gjyqtari, mbledhja e pagesave të paligjshme dhe marrja e ryshfetit. Me ndryshimet kushtetuese në vitin 1974, shtetet përbërëse të federatës në ligjet e tyre penale i parashohin veprat penale kundër detyrës zyrtare. Në ligjin penal të vitit 1977 në krye të veprave penale kundër detyrës zyrtare kanë qenë të cekur veprat penale: keqpërdorimi i pozitës zyrtare, marrje ryshfeti, dhënie ryshfeti, ndërmjetësimi i kundërligjshëm.*<sup>18</sup> Pas pavarësisë së RM-së në vitin 1991 si shtet Sovran në kumvendin e saj më 1 nëntor 1996 ka miratur Kodin Penal i cili hyri në fuqi më 23 korrik 1996 ku janë të përfshira disa vepra penale me natyrë të korrupsionit siç janë: keqpërdorimi i detyrës zyrtare, marrja e rryshfetit, dhënia e rryshfetit, korrupsioni gjatë zgjedhjeve dhe votimeve, ndërmjetësimi kundërligjor. Ndërsa, në vitin 2002 RM-së për herë të parë miraton “ligjin për pengimin e korrupsionit (28/2002, 33/03, 89/05,126/06, 7/07, 10/08, 161/08, 145/10) i cili hyri në fuqi më 4 maj të të njëjtit vit dhe pothuajse në çdo vit pati plotësime dhe ndryshime.

<sup>17</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Korrupsioni\\_n%C3%AB\\_Maqedoni](https://sq.wikipedia.org/wiki/Korrupsioni_n%C3%AB_Maqedoni)

<sup>18</sup> Todor Vitlarov, Represija i Prevencija na Korupcijata, Shkup 2006, fq.25

### 3. Korniza juridike e Republikës së Maqedonisë

Ekziston një numër i madh ligjesh lidhur me korrupsionin. Ndër më të rëndësishmit janë: Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Kodi penal, Ligji mbi mbrojtjen e denoncuesve dhe Ligji për lobim.

Në përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit janë të adaptuara Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit dhe Konventa civile për parandalimin e korrupsionit. Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar këto dokumente dhe ato janë pjesë e legjislacionit të mbrendshëm.

**Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë**<sup>19</sup> i miratuar në vitin 1996 në kapitullin e tridhjetë në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare, si vepra penale të korrupsionit parasheh këto forma:

1. Marrjen e ryshfetit<sup>20</sup>
2. dhe dhënien e ryshfetit.<sup>21</sup>

Marrja e ryshfetit është vepra penale e parë e korrupsioni tsipas Kodit penal të Maqedonisë, e cila konsiston në kërkesën ose marrjen e dhuratave ose përfitimeve të tjera apo në marrjen e premtimeve për dhurata ose përfitime të tjera, nga një zyrtar ose personi përgjegjës që brenda kompetencave të tij/saj ka për të kryer një veprim zyrtar që nuk duhet të kryej ose për të mos kryer një veprim zyrtar të cilin ai duhet ta kryejë, si dhe duke kërkuar ose pranuar dhurata ose përfitime të tjera pas ekzekutimit ose mosekzekutimit e disa nga veprimet zyrtare në lidhje me to.

Veprën e dytë penale të korrupsionit në ligjin penal të Republikës së Maqedonisë e gjejmë nën emrin: "Dhënia e ryshfetit" e cila konsiston në dhënien apo premtimin e dhuratës ose përfitimeve të tjera te personit zyrtar përgjegjës, që në kuadër të kompetencave të tij zyrtare, të kryen një veprim zyrtar, që nuk duhet të ketë për të kryer ose për të mos kryer një veprim zyrtar që ai do të duhet ta kryente apo edhe në ndërmjetësimin në ryshfet në ndonjë nga këto forma.

Pas pavarësisë, Republika e Maqedonisë u bë anëtare e Kombeve të Bashkuara më 8 prill 1993, anëtare e OSBE-së më 12 tetor 1995, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me BE u mbyll

<sup>19</sup> Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.37/96

<sup>20</sup> Neni 357 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë

<sup>21</sup> Neni 358 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë



“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

më 9 prill 2001 dhe hyri në fuqi më 1 prill 2004 për në vitin 2005, Republika e Maqedonisë të marrë statusin e një vendi kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Të gjitha këto vite, duke filluar nga pavarësia në vitin 1991, autoritetet në Republikën e Maqedonisë kanë luftuar korrupsionin që ishte masivisht i pranishëm në të gjitha sferat dhe krimin e organizuar dhe si rezultat kemi nënshkruar dhe ratifikuar konventat më të rëndësishme ndërkombëtare dhe evropiane.

Republika e Maqedonisë është anëtare e Grupit të shteteve kundër korrupsionit (GREKO) që nga viti 2000. Më 27 janar 1999 në Strasburg u hap për nënshkrimin e Konventa ndëshkimore për korrupsionin, e cila u nënshkrua dhe u ratifikua nga Republika e Maqedonisë më 28 korrik 1999 dhe hyri në fuqi më 1 korrik 2002.

Në vitin 1999 u nënshkrua Konventa evropiane për ndihmën e përbashkët për çështjet kriminale.

Në vitin 2000, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin Transnacional u nënshkrua dhe u ratifikua në vitin 2005. Gjithashtu janë ratifikuar të dyja, Konventa e Këshillit të Evropës mbi të Drejtën Penale Kundër Korrupsionit (1999), Konventa për të Drejtën Civile Kundër Korrupsionit (2002) dhe Protokollin Shtesë të Konventës mbi të Drejtën Penale Kundër Korrupsionit (2005).

Në vitin 2007. Maqedonia e ratifikoi Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit. Kur bëhet fjalë për tekst ligjor të veçantë në kuadrin ligjor vendor, është veçanërisht e rëndësishme të përmendet ligji i parë për parandalimin e korrupsionit i vitit 2002, i cili përmban një numër dispozitash për forcimin e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit si në administratën publike ashtu edhe në funksionarët e zgjedhur / të emëruar.

Në nëntor të vitit 2002 gjithashtu u krijua Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, i cili sot ka rolin e një trupi të pavarur përgjegjës për zbatimin e masave anti-korrupsion dhe konflikteve të interesit.

Në vitin 2004, me miratimin e Ligjit të ri për Prokurorinë Publike Themelore u krijua Seksioni për vepra penale në fushën e krimin të organizuar dhe korrupsionit, i cili në vitin 2007 u bë zyra e posaçme e prokurorisë për trajtimin e rasteve të lidhura me krimin e organizuar dhe korrupsionin në nivelin e të gjithë territorit të Republikës së Maqedonisë.

**Neni 31** i Ligjit mbi Prokurorinë Themelore Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 150, data 12.12.2007) i përcakton kufijtë e veprimit të prokurorisë publike, por,

ndër të tjera, jep një pasqyrë të qartë se çfarë do të trajtohet si korrupsion dhe cilat vepra të kodit penal janë të përfshira.

**Neni 31:** "Prokuroria Themelore publike e prokurorisë për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit është kompetente të veprojë:

- për vepra penale të kryera nga një grup i strukturuar i tre ose më shumë personave që kanë një periudhë të caktuar kohore dhe veprojnë në mënyrë që të kryejnë një ose më shumë vepra penale, për të cilat parashikohet një dënim me burg prej të paktën katër vjet me qëllim në mënyrë direkt ose indirekt, të fitohet dobi financiare ose dobi tjetër;
- për veprat penale të kryera nga një grup i strukturuar ose organizatë kriminale në territorin e Republikës së Maqedonisë, në shtete të tjera ose kur vepra penale është përgatitur ose planifikuar në Republikën e Maqedonisë ose në një vend tjetër;
- për veprat penale shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 353 paragrafi (5), marrja e ryshfetit me vlerë të konsiderueshme të përmendur në nenin 357 dhe ndërmjetësimi i paligjshëm i referuar në nenin 359 i të gjithë nga Kodi Penal, të kryera nga një funksionar i përzgjedhur apo i emëruar, person zyrtar ose person përgjegjës i zgjedhur juridik dhe
- për vepra penale, prodhim të paautorizuar dhe lëshimin në shitje të narkotikëve, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 paragrafi (2), shpëlarjen e të parave dhe të ardhurave të tjera të një vepre penale me vlerë më të madhe se neni 273, kërcënim i terrorist ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë nga neni 313, ryshfet me vlerë të konsiderueshme nga neni 358, ndikimi i paligjshëm ndaj dëshmitarëve nga neni 368-a paragrafi (3), shoqata kriminale nga neni 394, organizata terroriste nga neni 394-a, terrorizmi nga neni 394-b, veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore nga neni 418-a, veprat penale të kontrabandimit me emigrantët nga neni 418-b, trafikimi i të miturve nga neni 418-g dhe krime të tjera kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare të Kodit Penal, pavarësisht nga numri i autorëve ". Ky nen pasqyron qartë format e ndryshme në të cilat mund të paraqitet korrupsioni, që nënkupton se ajo është e pranishme drejtpërdrejt ose indirekt në pjesën më të madhe të jetës së njerëzve.

Numri i konventave të nënshkuara dhe të ratifikuara si dhe ndryshimet e shumta ligjore flasin për ekzistencën e një vullneti të sinqertë dhe një angazhimi nga shteti për shtypjen e korrupsionit dhe trajtimin e krimit të organizuar. Por, të njëjtat nuk përbëjnë në vetvete një garanci se ajo që

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

shkruhet dhe parashikohet në to do të jetë dhe do të zbatohet në tërësi. Prania agresive e korrupsionit kërkon një strukturë të fortë institucionale, që është, institucione dhe organe shtetërore të kualifikuar dhe të ndërlidhur që do të mund t'i mbrojnë në mënyrë efektive qytetarët, por gjithashtu t'i zbulojnë rastet e korrupsionit dhe / ose krimet të organizuar.

#### **4. Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe Institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë, aktorë kryesorë në luftën kundër korrupsionit**

**Ministria e Punëve të Brendshme për parandalimin dhe trajtimin e veprave penale dhe abuzimeve, zbulimin dhe kapjen e autorëve dhe marrjen e masave të tjera për ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale, është një nga institucionet kyçe që merret me parandalimin e korrupsionit.**

Trupat që ekzistojnë brenda Ministrisë përfshijnë Byronë e Sigurisë Publike, Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim, si dhe ekzistenca e një Kontrolli të brendshëm për standardet profesionale, e cila është një njësi e veçantë organizative e Ministrisë që kryen vlerësim të ligjshmërisë së veprimtarisë së punonjësve në Ministri. Ky kontroll i brendshëm miraton program anti-korrupsion që synon reduktimin e korrupsionit dhe futjen e një kulture antikorrupsion në mesin e punonjësve të ministrisë, e cila do të jetë në të njëjtin nivel me atë të policisë evropiane dhe do ta forcojë integritetin e punonjësve në ministri.

***Seksioni i Krimit të Organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme*** është përgjegjës për parandalimin dhe ndjekjen penale të kryerësve të krimit të organizuar dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me Seksionin për ndjekjen e kryerësve të veprave penale dhe korrupsion në kuadër të Prokurorisë publike.<sup>22</sup>

***Seksioni për çështjet kufitare dhe emigrimin*** është formë e veçantë organizative brenda Byrosë së sigurisë publike - Ministria e Brendshme, e cila përveç përgjegjësisë të tjera për menaxhimin e sigurisë kufitare, lufton krimin ndërkufitar, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe bashkëpunimin ndërinstytucional me entitetet e tjera në Sistemin për menaxhim të Integruar të kufijve.<sup>23</sup>

***Seksioni i Krimit të Organizuar në Gjykatën Themelore Shkup 1*** është seksion i veçantë për rastet që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

***Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit*** miraton Programin Shtetëror për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit dhe planeve të veprimit për zbatimin e tij, e miraton

---

<sup>22</sup> Neni 3 i Ligjit për Punë të Brendshme i Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 42/2014)

<sup>23</sup> IBID

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

programin vjetor, planifikon punën dhe përgatit mendime mbi projektligjet e rëndësishme për parandalimin e korrupsionit.<sup>24</sup>

**Policia Financiare** është themeluar më 26 qershor dhe është organ brenda Ministrisë së Financave (Gazeta Zyrtare 55/02, 26 qershor 2003). Për herë të parë, sipas Ligjit për Policinë Financiare (Gazeta Zyrtare 55/02) vepron si një trup i administratës shtetërore përgjegjëse për ndjekjen penale, gjatë çka siguron kompetenca të veçanta dhe specifike, të tilla si zbulimi i autorëve të përfshirë në veprimtari të paligjshme në fushën e krimit financiar, pastrimit të parave dhe llojeve të tjera të krimit, d.m.th, kontrabandës, shmangies së taksave ose evazionit domethënës të detyrimeve të mëdha doganore dhe detyrimeve të tjera tatimore.<sup>25</sup>

Në vitin 2007, u miratua Ligji i ri për Policinë Financiare (Fig. Gazeta Nr. 55/07) dhe në përputhje me të njëjtën, Policia financiare bëhet Autoriteti i Policisë Financiare, një organ brenda Ministrisë së Financave me kapacitet të një personi juridik.<sup>26</sup>

Drejtoria e policisë financiare ka kompetenca në procedurën para hetimore dhe në hetimin, në rastet kur merret me zbulimin e veprave penale dhe autorët e tyre si dhe mbledhjen e provave për ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale: evazoni fiskal (neni 279 i KP); pastrimi i parave dhe të ardhurat e tjera nga vepra penale (neni 273 i KP); kontrabandë (neni 278 i KP); tregti e palejuar (neni 277 i Kodit Penal) dhe vepra të tjera penale që përfshijnë shuma më të mëdha dhe të konsiderueshme të tatimeve, doganave apo të ardhurave të tjera.<sup>27</sup>

#### ***Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit***

#### **Misioni i Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit:<sup>28</sup>**

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit ndryshon dhe inicon ndryshim të ligjeve, ngritje normative dhe përforcim institucional, krijim të politikave dhe masave anti-korrupsion, promovon bashkëpunimin mes institucioneve dhe bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillon kulturën juridike.

#### **Vizioni i komisionit për parandalimin e korrupsionit:<sup>29</sup>**

Sistem i vendosur efikas për parandalimin e korrupsionit dhe shtypjen dhe përplasjen e interesave.

<sup>24</sup> Nuredinoska E. Sazdeski M. Gjuzellov, B. Raporti për vlerësimin e korrupsionit.

<sup>25</sup> [http://finpol.gov.mk/za\\_upravata.html](http://finpol.gov.mk/za_upravata.html)

<sup>26</sup> [http://finpol.gov.mk/za\\_upravata.html](http://finpol.gov.mk/za_upravata.html)

<sup>27</sup> IBID

<sup>28</sup> <https://www.dksk.mk/index.php?id=16>

<sup>29</sup> Po aty

Komisioni shtetëror është organ autonom dhe i pavarur në kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj dhe është person juridik. Komisioni shtetëror është i përbërë nga shtatë anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, dhe presidenti zgjedhet nga rradhët e anëtarëve të emëruar. Për anëtar të Komisionit mund të emërohet personi i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe ka vendbanim të përhershëm në R.M., si dhe arsimim të lartë në fushat juridike, çështjet financiare dhe kundër korrupsionit, si dhe te ketë reputacion të mirë për kryerjen e funksionit. Anëtarët e Komisionit shtetëror kanë cilësinë e personit të emëruar dhe janë të detyruar funksionin ta kryejnë në mënyrë profesionale, ndërsa për punën e tyre përgjigjen para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Komisioni shtetëror ka kompetencat të parashikuara me ligj. Ai informon publikun për aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura. Në qoftë se para Komisionit shtetëror udhëhiqet procedurë për të sqaruar disa çështje të përcaktuara, të rëndësishme për të sjellur vendim, Komisioni mund të ftojë personin kundër të cilit është duke marrë veprim, si dhe persona të tjerë të cilët mund të kontribuojnë për të qartësuar faktet e një rasti të veçantë. Komisioni shtetëror mund të kërkon prej cilit do person zyrtar të dhëna dhe raporte mbi asetet e tij ose asetet e anëtarëve të tjerë të familjes, për ndryshimet në asetet, për veprimtarinë që kryen ai ose anëtarë të tjerë të familjes së tij, të ardhurat e gjeneruara si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme, me qëllim parandalimin e korrupsionit. Komisioni shtetëror të dhëna dhe raporte mund të kërkojë edhe nga organet kompetente ose personave juridik, të cilet janë të obliguar pa vonesë dhe në afat prej 15 ditësh të sigurojnë të dhënat e kërkuara. Në raste kur bëhet fjalë për informacione të klasifikuara trajtohet në bazë të ligjit në fuqi. Në rast se personi përgjegjës nuk i përgjigjet kërkesës së personit juridik, Komisioni shtetëror mund të fillojë procedurë para organit kompetent për përcaktimin e detyrimit të tij.<sup>30</sup>

Zbaton dhe inicon zbatimin “Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit punon me kapacitet të plotë, në mënyrë transparente, opinionin është i njoftuar me punën e tyre. Është dëshmuar se punon në mënyrë joselektive, ndërsa ndryshimet janë parë që nga mënyra e përzgjedhjes së përbërjes së re. Duhet të vazhdojë të punojë në mënyrë joselektive, por të përpunojë edhe punët më serioze dhe më të rëndësishme për korrupsion dhe konflikt interesi”.<sup>31</sup>

<sup>30</sup> <http://myla.org.mk/wp-content/uploads/2018/01/ALB-brosura-90x140-za-PRINT.pdf>

<sup>31</sup> <https://www.almakos.com/organizatat-qytetare-do-ta-monitorojne-punen-e-komisionit-per-parandalimin-e-korrupsionit-ne-maqedoni/>

## 5. Korniza ndërkombëtare

Zakonisht në vendet në tranzicion kemi përqindje më të madhe të korrupsionit, një ndër ato vende është Republika e Maqedonisë e cila është në një gjendje mjaft të vështirë për vitë me rradhë.

Përveç ligjeve dhe masave të cilat mund t'i quajm kombëtare, në vendin tonë janë të ratifikuara tri Konventa Ndërkombëtare:

1. Konventa penale për korrupsionin;
2. Konventa Civile për korrupsionin dhe;
3. Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit.

### 5.1. Konventa penale për parandalimin e korrupsionit

Konventa penale për parandalimin e korrupsionit e Këshillit të Evropës është ratifikuar nga parlamenti i Republikës së Maqedonisë dhe ka hyrë në fuqi më 26 maj të vitit 1999.<sup>32</sup>

Në kreun e dytë përcaktohen masat që duhet të merren në nivelin kombëtar nga shtetet nënshkruese të kësaj konvente dhe të tilla janë: masat legjislative kombëtare për përcaktimin si vepra penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të zyrtarëve publik, masat legjislative kombëtare për përcaktimin si vepër penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në sektorin privat, masat të karakterit të pastrimit të parave që janë produkt nga veprat e korrupsionit, masat legjislative për përcaktimin e përgjegjësisë që personat juridik mund të përgjigjen për veprat penale të korrupsionit, masa efektive dhe sanksione proporcionale dhe shtërnguese, përfshirë dënime për heqjen e lirisë, mbrojtja e bashkëpunëtorëve të drejtësise dhe dëshmitarëve si dhe masat legjislative për personat dhe organet që janë të specializuara ne luftën për korrupsion.

### 5.2. Konventa Civile për parandalimin e korrupsionit

Me anë të kësaj konvente secila palë do të sigurojë në ligjin e saj të brendshëm mjete juridike efektive për personat që kanë pësuar dëmtime si rezultat i akteve të korrupsionit, për t'iu lejuar atyre të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, përfshirë mundësinë e marrjes së kompensimit për dëmin.<sup>33</sup>

<sup>32</sup> Ligji për ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin, Gazeta zyrtare nr.32/1999

<sup>33</sup>

[http://www.unicri.it/topics/organized\\_crime\\_corruption/archive/training\\_albania/materials/1999\\_Civil%20Law%20Corruption\\_Convention.pdf](http://www.unicri.it/topics/organized_crime_corruption/archive/training_albania/materials/1999_Civil%20Law%20Corruption_Convention.pdf)

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

Konventa Civile për Korrupsionin është ratifikuar nga parlamenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila hyri në fuqi më 18 shkurt të vitit 2002.<sup>34</sup>

### **5.3. Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit Neni 1 Deklarimi i qëllimit<sup>35</sup>**

#### **Qëllimet e kësaj Konvente janë:**

- nxitja dhe forcimi i masave për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit më me efikasitet dhe efektivitet;
- nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rimarrjen e pasurisë;
- nxitja e integritetit, përgjegjësisë dhe administrimi i rregullt i çështjeve publike dhe pasurisë publike.

#### **MASAT PARANDALUESE<sup>36</sup>**

#### **Neni 5 Politikat dhe praktikat parandaluese kundër korrupsionit:**

- Secili shtet palë, në përputhje me principet themelore të sistemit ligjor të tij, zhvillon dhe zbaton ose ruan politika të efektshme dhe të koordinuara kundër korrupsionit që nxisin pjesëmarrjen e shoqërisë dhe reflektojnë principet e shtetit ligjor, administrimin e rregullt të punëve publike, pasurisë publike, integritetit, transparencës dhe përgjegjësisë;
- Secili shtet palë përpiqet të vendosë dhe të nxitë praktika të efektshme që synojnë parandalimin e korrupsionit;
- Secili shtet palë përpiqet të vlerësojë periodikisht instrumentet përkatëse ligjore dhe masat administrative me qëllim që të përcaktojë përshtatshmërinë e tyre për të parandaluar dhe luftuar kundër korrupsionit;
- Shtetet palë, siç duhet dhe në përputhje me principet themelore të sistemit të tyre ligjor, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me organizatat ndërkombëtare dhe regionale në nxitjen dhe zhvillimin e masave të përmendura në këtë nen. Ky bashkëpunim mund të përfshijë pjesëmarrjen në programe dhe projekte ndërkombëtare që synojnë parandalimin e korrupsionit.

<sup>34</sup> Ligji për ratifikimin e Konventës Civile për Korrupsionin, Gazeta zyrtare nr.13/2002

<sup>35</sup> <http://levizjafol.org/wp-content/uploads/2015/09/KONVENTA-E-KOMBEVE-T%C3%8B-BASHKUARA-KUND%C3%8BR-KORRUPSIONIT.pdf>

<sup>36</sup> <http://levizjafol.org/wp-content/uploads/2015/09/KONVENTA-E-KOMBEVE-T%C3%8B-BASHKUARA-KUND%C3%8BR-KORRUPSIONIT.pdf>



## KAPITULLI II

### II. FORMAT, SHKAQET DHE PASOJAT E KORRUPSIONIT

#### 1. Format e korrupsionit të pranishme në sistemin e administrimit të drejtësisë në Republikën e Maqedonisë

Me nocionin Kod Penal nënkuptojmë ligjin e rëndësishëm në të cilin në mënyrë të tërësishme dhe të sistemuar përmbledhen dispozitat penalo-juridike. Kodi Penal konsiderohet akt juridike me fuqi më të madhe juridike.

Me Kodin Penal parashihet edhe korrupsioni dhe veprat të cilat konsiderohen korrpsion. Korrupsioni ka një varg të gjërë të efekteve të dëmshme për shoqërinë. Ai dëmton rëndë demokracinë dhe sundimin e ligjit, kërcënon cilësinë e jetës, mund të shkaktojë paraqitjen e krimet të rëndë dhe kërcënon sigurinë e të gjithë komunitetit shoqëror. Lufta kundër korrupsionit nuk është proces i thjeshtë, por nënkupton angazhim të të gjithë komunitetit shoqërorë dhe nismë në të gjitha nivelet. Çdo individ ka obligim moral dhe ligjor të luftojë kundër korrupsionit. Kjo do të thotë jo vetëm njohjen e korrupsionit dhe përmbajtje nga aktet korruptive, por edhe raportimin e rasteve të korrupsionit. Republika e Maqedonisë është shtet demokratik, social në të cilën të gjithë para ligjit janë të njëjtë, ndërsa një ndër vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë ndër të tjerash është edhe respektimi i principeve demokratike dhe të drejtave të njeriut. Mirëpo, sa i përket nivelit të korrupsionit ai nuk lidhet drejt me sistemin shtetëror por shkaqet mund të lidhen me kulturën, mentalitetin dhe traditat e një shoqërie të caktuar. Në shoqëritë ku korrupsioni gati përligjet është shumë më e vështirë të ndryshohen veset e jetesës dhe të menduarit.

Korrupsioni është një e keqe shoqërore dhe politike me rrënjë shumë të forta, andaj edhe lufta kundër tij është shumë e vështirë dhe e përbërë. Në botën modern në demokracinë parlamentare dhe kapitalizmin që tashmë kanë marrë karakter global, korrupsioni perceptohet si braktisje e interesit publik në emër të interesit privat. Korrupsioni është një fenomen, veçanërisht i shteteve dhe vendeve në zhvillim si dhe karakteristikë e atyre që sapo kanë hedhur pas të shkuarën autoritariste apo sistemin totalitar.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut veprat penale parashikohen në Kodin Penal.

Në bazë të Kodit penal janë parashikuar një numër veprash penale kundër detyrës zyrtare:

1. **Keqpërdorimi i detyrës dhe të autorizimit zyrtar (neni 353);** Keqpërdorimi i detyrës dhe të autorizimit zyrtar ekziston në tre raste:
  - Kur personi zyrtar do të përdorë kompetencat apo autorizimet zyrtare për të ndërmarrë një veprim të caktuar, pra veprime kundër rregullave dhe kodeve;
  - Kur personi zyrtar do të tejkalojë kompetencat e tij zyrtare (ndërmarrja e aktivitetit duhet të ketë karakter zyrtar për të cilën personi nuk ka autorizim. Nuk paraqet tejkalim të kompetencave nëse veprimi nuk ka të bëjë me ndërmarrjen e veprimtarisë zyrtare - për shembull, nëse personi zyrtarë kryen vjedhje ose vepër me lëndime të lehta) ose
  - Kur personi zyrtar nuk do të kryejë detyrimet zyrtare, në të gjitha rastet, personi zyrtar realizon ndonjë dobi për vete ose për dikënd tjetër ose në dëm të dikujt tjetër. Dobia, gjegjësisht dëmi, mund të jetë i natyrës pronësore ose materiale, por gjithashtu mund të jetë e shfaqur edhe në dobi jomateriale ose dëm (për shembull: përdorimi i makinave zyrtare, fitimi pa rend i lokacionit për ndërtim ose banesë dhe të ngjajshme; dëme: dëmtimi i reputacionit dhe nderit dikujt tjetër dhe të ngjajshme).

## 2. **Puna e pandërgjegjshme në shërbim (neni 353);**

Ky trajnim mund të jetë prezent në veprimtari me anë të së cilave shkelet një rregullore formale, keqpërdoren autorizimet diskrete ose lëshohet mbikqyrje e detyrueshme. Nën mënyrë tjetër të trajtimit të dukshëm të pandërgjegjshëm nënkuptohen veprimtari të ndryshme të kryerjes së paregullt dhe joetik të shërbimit (në kundërshtim me normat e etikës profesionale të personave zyrtarë për veprim në raste të mundshme të korrupsionit, konflikt interesi). Pasoja e kësaj vepre është përfitim për vete ose për dike tjetër ndonjë dobi. Kodi penal parashikon dënim me burg prej tre muaj deri më tre vjet për trajtim të pandërgjegjshëm të personave zyrtarë.

## 3. **Abuzim në shërbim (neni 354);**

Nënkupton përfitime dobi pronësore të paligjëshme për vete ose për dikë tjetër, në mënyrë që personi zyrtar do të përvetësojë të holla, letra me vlerë ose mjete të tjera të luajtshme të besuara në shërbim. Për këtë vepër është i paraparë dënim me burg prej gjasht muaj deri në tre vite. Në rast se me kryerjen e kësaj vepre përfitohet dobi më e madhe pronësore ose shkakton dëme më të mëdha pronësore ose në mënyrë të rëndë do të cënohen të drejtat e

dikujt tjetër, dënimi është me burg prej gjasht muaj deri më pesë vjet. Në rast kur është fituar dobi pronësore e konsiderueshme, dënimi është me burg prej më së paku katër vjet, ndërsa për dobi të vogël pronësore është i paraparë dënim në të holla ose me burg prej një viti.

#### **4. Mashtrimi në shërbim (neni 355);**

Personi zyrtar i cili gjatë kryerjes së shërbimit me qëllim për vete ose dikë tjetër të përvetson dobi pronësore të paligjshme do të dorëzon llogari të rrejshme ose në tjetër mënyrë do të sjell habit te personi i autorizuar të bëjë pagesa joligjore, do të dënohet me burg prej gjasht muaj deri më pesë vjet.

#### **5. Përdorimi i shërbimeve në detyrë (neni 356);**

Personi zyrtar duke përdorur kompetencat e veta ndikon në zgjedhjen e personit udhëheqës (drejtor) i cili është më pak i kualifikuar se kandidatët e tjerë vetëm për të fituar dobi për vete ose me qëllim të dëmton dikë prej kandidatëve të tjerë.

#### **6. Marrja e ryshfetit (neni 357);**

Për ryshfet bëhet fjalë kur personi zyrtar nuk vepron në bazë të ligjit, në suazat e kompetencave dhe obligimeve të tij me qëllim të përvetson për vete ose për dikë tjetër ndonjë dobi. Kjo do të thotë rryshfeti ekziston kur për atë qëllim, personi zyrtar përfiton prej kryerjes së detyrave të tij, gjegjësisht paguhet për kryerjen e detyrave të tij. Me fjalë ndryshe, personi zyrtar nuk guxon të fitojë dhuratat, premtim për dhuratë ose dobi tjetër, për të vepruar në mënyrë në të cilën ai duhet rregullisht të kryen punën e tij, e cila mund të përbëhet edhe në mos ndërmarrjen e ndonjë veprimi të cilin është i detyruar ta ndërmerr. Ryshfeti i këtij lloji dënohet më dënim me burg prej një deri më pesë vjet. Ryshfeti ekziston edhe kur personi zyrtar do të veprojë në kundërshtim me ligjin me atë që do të kryen ndonjë veprim të caktuar të cilin nuk ka guxuar ta ndërmerr ose kur nuk kryen ndonjë veprim të cilin ka qenë i obliguar ta ndërmerr. Për këtë vepër është paraparë dënim me burg prej katër deri më dhjetë vjet. Nëse personi zyrtar kërkon, pranon ose dakordohet të pranon dhuratat apo ndonjë dobi tjetër, pas veprimit në ndonjë mënyrë nga të përmendurat më lartë, do të ballafaqohet me dënim prej tre muaj deri më tre vjetë dhe me ndalesë për kryerjen e shërbimit prej një deri më dhjetë vjet.

7. **Dhënie shpërblimi për ndikim të paligjshëm (neni 358-a);** Kur personi zyrtar do të keqpërdorë kompetencat zyrtare dhe do të përdorë ndikimin e tij për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim të caktuar në suazat e kompetencave të tij me qëllim të ndikojë mbi

administratën publike, punësimin, lidhjen e kontratës ose sjelljen e vendimeve (te favorizuar), kryen veprë penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej një deri më tre vjet.

8. **Pranimi i shpërblimit për ndikim të paligjshëm (neni 359);** Personi zyrtar nuk guxon të pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë dobi, premtim ose ofertë për dobi të tillë për vetë apo dikë tjetër, që të përdorë ndikimin e tij real apo të supozuar, kompetencat zyrtare, me qëllim të intervenojë ose të nxit kryerjen e veprimit zyrtar që duhej të kryhet ose të mos kryhet veprim.

9. **Fitimi dhe mbulimi i paligjshëm i pronës (neni 359-a);** Personi zyrtar apo personi përgjegjës në ndërmarrje publike, insitucion publik apo subjekt tjetër juridik i cili disponon me kapital shtetëror ka obligim ligjor te raportoje pasurinë e tij apo ndryshimin e saj, të jep te dhëna te plota dhe të sakta për pasurinë e tij apo të të anëtareve të familjes së tij. Nëse vepron ndryshe, do të dënohet me burg prej gjasht muaj deri më pesë vjet. Dënimi do te shqiptohet në momentin kur do të vërtetohet se gjatë ushtrimit te funksionit apo detyrës, personi apo pjestari i familjes së tij ka fituar pasuri në një vlerë të konsiderueshme që tejkalon te ardhurat e tij ligjore, ka dhëne të dhëna të reme apo ka fshehur burimet e verteta të të ardhurave. Perveç dënimit, parashikohet edhe konfiskimi i pasurisë.

**10. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 360) dhe pagesa joligjore:**

Personi zyrtar i cili në publik apo personit të paautorizuar ia kumton, përcjell ose në ndonjë mënyrë tjetër mundëson qasje në të dhëna të cilat paraqesin sekret zyrtar, ose mbledh të dhëna të tilla me qëllim që t’ia kumton apo përcjell personit të paautorizuar ose në publik, dënohet me burg prej tre muaj deri më pesë vjet.

Sekrete zyrtar llogariten te dhënat dhe dokumentet të cilat me ligj apo me dispozite tjetër ose me vendim të organit kompetent të nxjerra në pajtim me ligjin, janë të shpallura si sekret zyrtar dhe zbulimi i të cilave ka apo mund te ketë pasoja per shërbimin. Kushdo që komunikon sekret zyrtar nga lakmia apo për përdorimin e tyre jasht vendit, dënohet me jo më pak se një vjet.

Disa raste të tjera të cilat llogariten si korrupsion:

**Përdorim i shërbimeve në detyrë**

Personi zyrtar i cili në mënyrë të pautorizuar do të përdor të hollat, letrat me vlerë ose mjete të tjera të luajtshme të besuara në shërbim ose këto mjete pa autorizim do t’i jep në përdorim dikujt tjetër, do të dënohet me burg prej tre muaj deri më pesë vjet.

### **Dhënia e ryshfetit**

Dhënia e rryshfetit gjithashtu paraqet vepër penale e cila është në korelacion të ngushtë me pranimin e ryshfetit. Ryshfet - personi zyrtar në procedurën për dhënien e lejes për ndërtim ose implementimin e planit urbanistik, do të vepron në kundërshtim me rregullat e procedurës dhe do të ndihmon në dhënien e lejes për të cilën ka pengesa për tu dhënë për arsye se personi i interesuar i ka ofruar që do të kryej ndonjë shërbim dhe do të punëson dikë të afërt të tij.

Personi zyrtar i cili gjatë kryerjes së detyrës zyrtare kërkon nga personi tjetër të paguaj një shumë të caktuar, të cilën shumë ai nuk është i obliguar ta paguan, ose kërkon më shumë se shuma të cilën ai është i obliguar ta paguaj, apo gjatë pagesës ose dorëzimit të sendeve, personi zyrtar paguan ose dorëzon me pak se që është i obliguar, dënohet në të holla ose burgim deri në tre vjet.

**(sipas Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike)** Interesi publik është mbështetja ose promovimi i veprimtarive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në promovimin e kulturës, etikës, arsimit, shkencës, zhvillimit të shoqërisë informative dhe transferimit të të dhënave elektronike, sportit, mbrojtjes së mjedisit, veprimtarisë sociale humanitare, zhvillimit të shoqërisë civile, promovimit të dhurimit të gjakut, promovimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe veprimtarive të tjera të përcaktuara me ligj. Interesi publik paraqet interes më të gjërë shoqëror për të mirën e përbashkët dhe për prosperitetin e të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë. Prania e korrupsionit nënkupton rrezikimin e interesit publik. Personat që kryejnë punë me interes publik nuk guxojnë të keqpërdorin kompetencat e tyre për përfitime personale, Komisioni shtetëror mban llogari për respektimin e kësaj ndalesë dhe fillon procedure për shqyrtimin e gjendjes së pronës nëse ekziston dyshim se gjatë kryerjes së punëve në interes publik, gjendja e pronës së personit është rritur në disproporcion përkundër të ardhurave të rregullta ose të ardhurave të anëtarëve të familjes së tij.<sup>37</sup>

---

<sup>37</sup> <http://myla.org.mk/wp-content/uploads/2018/01/ALB-brosura-90x140-za-PRINT.pdf>

## 1.1. Ndërvarësia midis korrupsionit dhe pastrimit të parave

Korrupsioni paraqet dukurinë e rryshfetit të nëpunësit civil ose të personave që punojnë në një shoqëri private ose pranimi i çfarëdo lloj rryshfeti. Ndërsa në një kuptim të ngushtë, pastrimi i parave paraqet fshehjen e origjinës së paligjshme të fitimeve nga krimi, d.m.th pastrimi i parave ka për qëllim shëndrrimin e parave të pista në para të pastra. Paratë e pista janë para ose ndonjë formë tjetër e pasurisë që rrjedhin nga një krim ose nga ndonjë keqbërje tjetër. Pastrimi i parave konsiston në një proces i cili errëson origjinën e parave dhe burimet e saj.

Pastrimi i parasë, korrupsioni dhe krimi i organizuar përbëjnë një dozë të theksuar të rrezikut për vendet në tranzicion. Me fjalë të tjera, një shoqëri në tranzicion.

Sipas disa vlerësimeve, tre faktorë kanë ndikuar në këtë bashkëpunim.

**Së pari**, liberalizimi i plotë i lëvizjes së kapitalit që nga vitet 80 të shekullit të kaluar, dmth lëvizja e lirë e kapitalit pa ndonjë kontroll nacional dhe ndërkombëtarë.

**Së dyti**, pastrimin e parave e mundëson rritja dhe çmilitarizimi i transaksioneve financiare.

**Së treti**, pastrimi i parave mund të realizohet nëpërmjet rritjes së numrit të vendeve në të cilat këto transaksione mund të realizohen dhe në të cilat tolerohet kriminaliteti financiar. Sipas vlerësimevetë Fondit Monetar Ndërkombëtar, vlera e parave të pista sillet rreth 590-1500 miliardë dollarë amerikan.<sup>38</sup>

---

<sup>38</sup> Prona dhe procesi i transformimit dhe i privatizimit

## 2. Mënyrat dhe llojet e korrupsionit

### 2.1. Mënyrat e korrupsionit

Kur korrupsioni përfëshin të paktën dy persona, kontakti mes tyre arrihet në dy mënyra:

- **Drejtëpërdrejt:** kjo kërkon besim të madh midis palëve, që zakonisht bazohet tek miqësia, kontaktet e mëparshme ose rekomandimi nga një person tjetër që e beson agjenti publik. Kjo mund të përfëshijë edhe mënyrat e presionit që rezultojnë nga marrëdhëniet e autoritetit (psh me një epror), ose nëpërmjet shantazhit.
- **Tërthorazi:** kjo kërkon përdorimin e ndërmjetësve. Këto mund të jenë bashkëpunorët aktual ose të mëparshëm, pjestarët e familjes ose personat me të cilët zyrtari hyn në kontakt shpesh, të tillë si personeli ndihmës i gjykatës, avokatët ose madje fqinjët e gjyqtarëve ose prokurorëve. Kontakti mund të bëhet për një akt të vetëm të paligjshëm korrupsioni ose aim und të përsëritet (vepër penale e vazhduar).<sup>39</sup>

### 2.2. Llojet e korrupsionit

#### 2.2.1. Korrupsioni sistematik kundrejt atij sporadik

**Korrupsioni sistematik (endemic)** është korrupsion që formon një pjesë të rëndësishme dhe të qenësishme të sistemit ekonomik, social dhe politik. Meqenëse virtualisht të gjitha institucionet dhe aktivitetet përdoren dhe kontrollohen nga individë, qytetarët nuk kanë alternativë tjetër por të pranojnë dhe të përfëshihen në këto shkelje.<sup>40</sup>

#### 2.2.2. Korrupsioni funksional kundrejt atij jofunksional

**Korrupsioni funksional** synon të lehtësojë përfundimin e ligjshëm të veprimeve të caktuara. **Korrupsioni jofunksional** është korrupsioni që çon në pengimin e aktiviteteve. Përdorimet e ofruara ose të marra në këtë rast përfëshijnë vlerë të lartë.

#### 2.2.3. Korrupsioni në sektorin publik kundrejt sektorit privat

Korrupsioni në sektorin publik përfëshin:<sup>41</sup>

---

<sup>39</sup> Cristi Danilet, Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë, Tiranë 2011, fq.57

<sup>40</sup> Po aty fq.62

<sup>41</sup> Po aty, fq.62

- **Korrupsionin administrativ:** ka lidhje me aktivitetin e administratës vendore dhe qëndrore publike, autoritetet e doganës, kujdesin shëndetësor dhe asistencën sociale, kulturën dhe arsimin, rendin publik dhe institucionet e sigurisë kombëtare;
- **Korrupsioni gjyqësor:** lidhet me autoritetet gjyqësore, prokuroritë dhe gjykatat;
- **Korrupsioni ekonomik:** përfëshin në veçanti sistemin financiar-bankar por edhe bujqësinë, pyjet, fushat e caktuara industrial dhe industritë e hekurit, çelikut dhe naftës;
- **Korrupsioni politik:** kryesisht ndikon në aktiitetin parlamentar dhe partitë politike nëpërmjet heqjes së imunitetit politik, duke ndikuar nismat legislative dhe duke ndikuar financimin e partive politike dhe të fushatave elektorale.

Korrupsioni në sektorin privat përfëshin operacionet tregtare të kryera nga shoqëritë ndërkombëtare ose shumëkombëshe. Ai ndërhyt në konkurrencën e drejtë dhe rregullat e ekonomisë të tregut të lirë, redukton cilësinë e produkteve dhe shërbimeve dhe minon investimet ekonomike. Krimet e korrupsionit shpesh përfëshijnë zyrtarët (mitën private-publike) të cilët koruptohennë shkëmbim të dhënies së lehtësirave fiskale ose kontratave të caktuara shoqërive të caktuara. Kjo mund të shkojë nga kontratat e prokurimit në shkallë të vogël deri në koncesionet për prodhimin e armëve dhe koncesioneve për burimet natyrore. Po kaq i rrezikshëm është dhe korrupsioni brenda shoqërisë.<sup>42</sup>

#### 2.2.4. Korrupsioni aktiv kundrejt korrupsionit pasiv

**Korrupsioni aktiv** konsiston në ofrimin ose prentimin e përfitimeve një vendimmarrësi (dhënie mite, tregti influence).

**Korrupsioni pasiv** konsiston në pranimin e këtyre përfitimeve (marrje mite, marrje e përfitimeve të padrejta, tregtim influence).

#### 2.2.5. Korrupsioni i zi, gri dhe i bardhë

**Korrupsioni i zi** ka lidhje me sjelljet e censuruara si nga publiku i gjerë dhe elitat. Korrupsioni gri ka lidhje me aktytet e korrupsionit që dënohen vetëm nga elitat. **Korrupsioni i bardhë** i referohet veprimeve dhe sjelljeve antisociale penaliteti i të cilave nuk dëshirohet nga asnjë kategori shoqërore dhe që konsiderohet si i tolerueshëm. Ai përfëshin lobimin si dhe “dhurata” të vogla (psh lule) që i jepen një mësuesi, një doktori etj.

---

<sup>42</sup> Cristi Danilet, Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë, Tiranë 2011, fq.63



### 3. Shkaqet e korrupsionit

Janë të njohur disa indikatorë të rritjes së korrupsionit. Në vijim do të veçojmë: Ndërhyrjen shtetërore në sferën e ekonomisë, nëpërmjet ligjeve dhe urdhëresave të ndryshme, sistemi fiskal, vendimet shtetërore për shpenzimet publike ku hynë edhe sigurimi i prodhimeve me çmime që janë më të ulëta se në treg, financimi i partive politike etj.<sup>43</sup>

Por ndër indikatorët që më së shumti ndikojnë në rritjen e korrupsionit janë:

- Burokracia tradicionale;
- Të ardhurat e ulta;
- Mosfunksionimi i sistemit gjyqësor;
- Kontrolli i pamjaftueshëm institucional;
- Rregullat ligjore jo transparente;
- Si dhe vet shembulli i udhëheqësve.

Viteve të fundit janë paraqitur edhe disa indikatorë që kanë ndikuar me të madhe në rritjen e korrupsionit si për shembull:

- Rritja e intervenimit të shtetit në ekonomi;
- Rritja e tregtisë ndërkombëtare;
- Si dhe ndryshimet e sistemeve qeverisëse, sidomos kalimi i sistemeve post socialiste në ato demokratike.

---

<sup>43</sup> [https://pashtriku.beepworld.de/files/kosova\\_2010/mars\\_2010/elifa\\_luzha\\_kashtkorrupsioni\\_31.3.10.htm](https://pashtriku.beepworld.de/files/kosova_2010/mars_2010/elifa_luzha_kashtkorrupsioni_31.3.10.htm)

#### 4. Format e korrupsionit më të përhapura në Republikën e Maqedonisë së Veriut (të dhëna nga anketimi)

- **Mitdhënia:** përfëshin dy individë atë që premtion dhe jep diçka dhe atë që e merr;
- **Dhuratat:** përfëshin marrjen e përfitimeve duke ushtruar detyrën, që jo domosdoshmërisht ka synimin për të shtrembëruar trajtimin e atij procesi, por që mund të lehtësoje vendosjen e marrëdhënieve joetike;
- **Mashtrimi:** lidhet me falsifikimin e të dhënave, në formën e mashtrimit intelektual, falsifikimi, ndihma dhe mbështetja;
- **Shantazhi:** përfëshin marrjen e përfitimeve me anë të presionit dhe forcës (psh një individ mund të kërcënohet me armë, ndëshkime administrative ose ndjekje penale në qoftë se ai ose ajo nuk adpoton sjelljen e dëshirar);
- **Trajtimi preferencial:** konsiston në dhënien e ndihmës miqve, njerëzve, të afërt për të përfituar pozicione për shkak të lidhjeve që kanë dhe jo për shkak të kompetencës.
- **Abuzimi me fonde:** ka të bëjë me keqpërdorimin e fondeve publike.
- **Përqindjet:** kur një individ i bën një favor të paligjshëm dikujt dhe ai e shpërblen me përqindje nga ajo punë.

## 5. Pasojat e korrupsionit

Efektet negative të korrupsionit janë të pranishme në të gjitha sferat e jetës sociale ekonomike dhe politike të vendit. Korrupsioni ka shumë kosto:

- Ai inkurajon konkurrencën në rryshfete, në vend të konkurrencës në cilësi dhe të asaj në të mira dhe shërbime;
- Ai pengon zhvillimin e një tregu normal;
- Mbi të gjitha ai frenon zhvillimin ekonomik dhe social, duke dëmtuar sidomos vendet në zhvillim ku bëjmë pjesë dhe ne. Në këto raste më të varfërit, të cilët mezi paguajnë koston e tyre duhet të paguajnë jo vetëm për korrupsionin e zyrtarëve të tyre, por edhe të atyre të kompanive nga vendet e zhvilluara.

Në rastin kur rryshfeti institucionalizohet, atëherë zyrtarët e korruptuar do të kërkojnë rryshfete gjithnjë e më të mëdha. Kur autoriteti moral i menaxherëve humbet, përmes korrupsionit në nivele të larta, aftësia e tyre për të kontrolluar vartësit zhduket. Flitet shumë për korrupsionin por, flitet pak për përmasat konkrete dhe provat e korrupsionit. Por, e keqja më e madhe nuk është thjesht rryshfeti, por keqdrejtimi ekonomik që iu imponohet bizneseve si dhe pengimi i institucioneve të administratës dhe qeverisjes është përmendur shpesh si korrupsioni i madh i cili bëhet për arsye praktike. Përballë sfidave të mbajtjes apo përmirësimit të standarteve të jetesës asnjë vend nuk mund ti bëjë ballë ineffiçencës që shoqëron korrupsionin.

Sipas statistikave, korrupsioni rrit koston e të mirave dhe shërbimeve, sjell investime të panevojshme, si dhe ul cilësinë e shërbimeve të infrastrukturës. Të dhënat e fundit mbi korrupsionin, tregojnë se përhapja e tij nuk është problem vetëm i vendeve në zhvillim, por dhe i vendeve të zhvilluara. Vendet e zhvilluara luajnë një rol të madh si dhënës i rryshfeteve në transaksionet e biznesit ndërkombëtar dhe janë të prekura edhe nga korrupsioni i brendshëm kryesisht ai politik. Sa më i përhapur të jetë korrupsioni në një shoqëri aq më i vogël është zhvillimi ekonomik dhe sa më i shpejtë të jetë zhvillimi ekonomik i një shteti aq më shpejt do të luftohet korrupsioni.

**Cilat janë disa nga pasojat negative të korrupsionit në shoqëri?**

**Pasojat në fushën ekonomike**

- Në shtetet e korrupuara, komuniteti i biznesit duhet të ndajë disa nga fondet e veta për korrupsionin, gjë që shkurton investimet dhe prodhimin kombëtar bruto;
- Korrupsioni i zë frymën konkurrencës së lirë, në mënyrë të veçantë kompanive të vogla;
- Me rënien e konkurrencës, ulet edhe cilësia e mallrave dhe e shërbimeve;
- Ulen të ardhurat shtetërore dhe rritet ekonomia në hije (informale);
- Aty ku tolerohet korrupsioni, punonjësit civilë marrin të ardhura të vogla dhe mbi qytetarët e thjeshtë rëndon mita që ata duhet të paguajnë për zgjidhjen e problemeve të tyre;
- Investitorët e huaj kanë më pak besim tek shteti dhe, për këtë arsye, kontributi i tyre ndaj ekonomisë së vendit bie.

Ndikimi i korrupsionit në aspektin ekonomik:<sup>44</sup>

1. Së pari, meqënëse suksesi ekonomik varet kryesisht nga shpërndarja optimale e burimeve, ndryshimi i destinacionit të fondeve, nëpërmjet aktiviteteve të korrupuara të menaxherëve dhe zyrtarëve përfaqëson një çrregullim të shpërndarjes dhe rrjedhimisht redukton burimet e disponueshme për rritjen ekonomike;
2. Së dyti, korrupsioni frikëson investitorët dhe dekurajon investimet e huaja direkte duke zvogëluar kështu përdorimin e burimeve të kapitalit human;
3. Në shtetet e korrupuara, komuniteti i biznesit duhet të ndajë disa nga fondet e veta për korrupsionin, gjë që shkurton investimet dhe prodhimin kombëtar bruto
  - Korrupsioni i zë frymën konkurrencës së lirë, në mënyrë të veçantë kompanive të vogla. · Me rënien e konkurrencës, ulet edhe cilësia e mallrave dhe e shërbimeve;
  - Ulen të ardhurat shtetërore dhe rritet ekonomia në hije (informale);
  - Aty ku tolerohet korrupsioni, punonjësit civilë marrin të ardhura të vogla dhe mbi qytetarët e thjeshtë rëndon mita që ata duhet të paguajnë për zgjidhjen e problemeve të tyre;
  - Investitorët e huaj kanë më pak besim tek shteti dhe, për këtë arsye, kontributi i tyre ndaj ekonomisë së vendit bie.

### **Pasojat në cilësinë e qeverisjes së shtetit**

- Ulet numri i investimeve publike dhe efikasiteti i ndërmarrjeve shtetërore;

<sup>44</sup> <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejte-penale/korrupsioni-dhe-vecorite-e-tij.html>

- Fushat e aktiviteteve qeveritare dhe strukturat e shpenzimeve i nënshtrohen ndryshimit – zyrtarë publikë të korrumpuar “miratojnë” projektet, të cilat garantojnë shuma më të mëdha;
- Egoizmi i zyrtarëve publikë lë në hije të menduarit strategjik në kuptimin e nevojave të shtetit, prandaj mungon vëmendja e duhur për problemet ekonomike dhe sociale
- Ulet cilësia e shërbimeve publike.

### **Pasojat socio-politike**

- Mirëqenia personale gjithnjë e më shumë vlerësohet më e rëndësishme se mirëqenia publike, e cila pothuajse lihet në harresë;
- Politikanët dhe punonjësit civilë fillojnë të keqpërdorin pozitën e tyre për të krijuar mirëqenie personale;
- Të rinjtë i shohin shërbimet civile si një mënyrë jetese sa e përshtatshme, aq edhe tërheqëse;
- Shoqëria e korrumpuar nuk arrin të shohë as motivet e luftës kundër korrupsionit. Vetë njerëzit nuk arrijnë të dallojnë nëse: janë të pakënaqur me praninë e korrupsionit si të tillë, apo me faktin që dikush tjetër dhe jo ata ka siguruar përfitime të mëdha ose më të mëdha?
- Pasoja kryesore e korrupsionit në aspektin politik është ulja e besimit të qytetarëve ndaj qeverisjes në përgjithësi dhe e qeverisë në veçanti si, përgjegjësjë kryesore për nivelin e korrupsionit. Nga ana tjetër ulja e besimit ndaj qeverisjes dhe qeverisë shoqërohet me pasoja të rënda për shoqërinë që lidhen me forcimin dhe respektimin e shtetit të së drejtës dhe shtetit social, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, etj.
- Mirëqenia personale gjithnjë e më shumë vlerësohet më e rëndësishme se mirëqenia publike, e cila pothuajse lihet në harresë. · Politikanët dhe punonjësit civilë fillojnë të keqpërdorin pozitën e tyre për të krijuar mirëqenie personale. · Të rinjtë i shohin shërbimet civile si një mënyrë jetese sa e përshtatshme, aq edhe tërheqëse. · Shoqëria e korrumpuar nuk arrin të shohë as motivet e luftës kundër korrupsionit. Vetë njerëzit nuk arrijnë të dallojnë nëse: janë të pakënaqur me praninë e korrupsionit si të tillë, apo me faktin që dikush tjetër dhe jo ata ka siguruar përfitime të mëdha ose më të mëdha? · Niveli i korrupsionit mund të lidhet me kulturën, mentalitetin dhe traditat e një

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

shoqërie të caktuar. Në shoqëritë ku korrupsioni gati përlijet është shumë më e vështirë të ndryshohen veset e jetesës dhe të menduarit. · Punonjësit civilë mund të demoralizohen nga pagat e ulëta, nga përgjegjësitë e punës që nuk kanë të bëjnë me llojin dhe cilësinë e saj, nga qëllimet jo të qarta të organizatës për të cilën punojnë dhe nga klientelizmi ndërmjet/midis eprorit dhe vartësit, etj.

Pra pasojat?

Katastrofale! Edhe pse shumica nga ne nuk i kuptojmë ato, ne ata i ndjejmë në përditshmëri. Polici që nuk mban rend, shkolla që nuk shkollojnë, mjek që nuk shërojnë, janë vetëm disa nga pasojat me të cilat ballafaqohemi çdo ditë. Korrupsioni poashtu shkatrron demokracinë. Ashtu siç shihet edhe nga raporti i TI, niveli i lartë i korrupsionit lidhet ngusht me nivelin ulët të demokracisë. Mirëpo, sa i kushton zhvillimit ekonomik në formë të zbrapjes së investimeve të huaja dhe dekurajimit të investimeve të brendshme? Dukshëm shumë! Linku në mes të nivelit të korrupsionit dhe të ardhurave për banor është sa i fortë aq edhe i qartë. Me një fjalë, korrupsioni edhe nëse na duket se ndonjëher na e lehtëson gjërat në jetën e përditshme, ai definitivisht na e vështirëson jetën në afat të gjatë.

## KAPITULLI III

### III. PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KORRUPSIONIT

#### 1. Komponentët e politikave antikorrupsion

Përcaktimi i nivelit të korrupsionit në një vend është shumë i vështirë për tu arritur. Megjithatë, ka të dhëna të ndryshme që të çojnë në përfundimin e pranuar gjerësisht se Maqedonia vuan ende nga nivele të larta të korrupsionit në shumë fusha. Kjo është një ndër arsyet që qeveria e ka vendosur luftën kundër korrupsionit në listën e përparësive më të rëndësishme të politikës së saj. Megjithatë, duhet pasur parasysh që jo gjithçka që shihet si korrupsion nga opinioni publik dhe media është me të vërtetë korrupsion. Ngjanjëherë, ekziston një perceptim i përciptë për arsyet, kushtet, pasojat e korrupsionit dhe rrugët për ta luftuar atë. Të gjitha masat që janë marrë apo të quajtura politika, qofshin në nivel kombëtar apo ndërkombëtar kanë një qëllim të vetëm ta parandalojnë korrupsionin, ta zbusin dhe ta luftojnë. Është e rëndësishme që institucionet e pushtetit vendor të përfshihen në programin anti – korrupsion të qeverisë duke adoptuar objektivat dhe politkat e lartpërmendura duke i përshtatur ato me specifikat e pushtetit vendor:<sup>45</sup>

- Krijimi i one stopshop në nivel vendor për ofrimin e shërbimeve dhe/ose lehtësimi i procedurave për marrjen e shërbimeve;
- Krijimi i faqeve web të përditësuara dhe publikimi i të dhënave në çdo njësi i buxheteve dhe shpenzimeve të çdo bashkie;
- Ofrimi i praktikave më të mira njësisive të reja të qeverisjes vendore lidhur me menaxhimin dhe raportimin e financave;
- Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal.

Implementimi i metodave antikorrupsion do të shpie jo vetëm te një rritje integriteti të personelit dhe vetë reformës së gjyqësorit, por ndoshta tek forcimi i metodave antikorrupsion duke siguruar pavarsinë dhe efikasitetin e sitemit.

<sup>45</sup> [http://www.mod.gov.al/images/PDF/Strategjia\\_Antikorrupsion2015\\_2020.pdf](http://www.mod.gov.al/images/PDF/Strategjia_Antikorrupsion2015_2020.pdf)

## 2. Përkufizimi i tipareve të politikave antikorrupsion

Në lidhje me grupet e saj objekt, një politikë e tillë së pari dhe kryesisht duhet të ketë objekt personelin në institucionet përkatëse, të cilëve u duhet kërkuar dhe u duhet inkurajuar sjellja e drejtë. Nga njëra anë, punonjësit duhet të këshillohen që të jenë të paanshëm dhe të përgjegjshëm, nga ana tjetër ata duhet të paralajmërohen për ndëshkimet që rrjedhin nga shkelja e ligjit ose standardeve të sjelljes.

Ajo duhet të trajtojë edhe individët jashtë institucioneve, dmth ata që u drejtohen ose mund tu drejtohen këtyre “shërbimeve”. Këta individë jo vetëm që duhet të trajtohen për llojin e sjelljes që ata kanë të drejtë të presin nga personeli me të cilin do të jenë në kontakt, por duhet edhe të paralajmërohen për pasojat potenciale nëse tentojnë të korrumpojnë zyrtarin.<sup>46</sup>

Në lidhje me gamën e saj, mund të hartohet një strategji e përgjithshme, e vlefshme për të gjithë institucionet, bashkë me një strategji sektoriale, për një fushë ose institucion specifik.

---

<sup>46</sup> Cristi Danilet, Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë, Tiranë 2011, fq.99



### 3. Metodatat për të parandaluar korrupsionin

Zvogëlimi i nivelit të korrupsionit nuk është një proces i lehtë as edhe i shpejtë në kohë. Ai lidhet me faktorë të shumtë historikë, ekonomikë e politikë të cilët veprojnë në shkallë, intensitete e forma të ndryshme në kohë dhe hapësirë.

Kohët e fundit nuk mungojnë edhe përpjekjet për të justifikuar aktet e korrupsionit, madje edhe për ta paraqitur atë të dobishëm për shoqërinë.

Në këtë këndvështrim, sipas disa ekonomistëve dhe politikanëve, korrupsioni është i dobishëm sepse ai:

- lehtëson procesin e vendimmarrjes, pasi ai i “vajis” rrotat makinerisë së shtetit dhe rrit efikasitetin e ekonomisë;
- kursen kohë dhe meqë “koha është para”, ai kursen paratë e shtetit;
- transferon parimet e konkurrencës së tregut të lirë në fushën e strukturave shtetërore;
- kompenson të ardhurat e vogla të shërbyesve civilë, duke kursyer fondet buxhetore. Meqenëse shkaqet e korrupsionit përfshijnë faktorë të ndryshëm të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë (përfshirë kryesisht politikën ekonomike të papërshtatshme, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e ulët të publikut, dobësinë e rolit të shoqërisë civile, mungesën e përgjegjshmërisë së institucioneve publike, vullnetin e dobët politik, kulturën apo mentalitetin e shoqërisë, etj.), lufta kundër korrupsionit duhet të ketë një përfaqje gjithëpërfshirëse.

*Korrupsioni mund të luftohet në rrugë të ndryshme.*

Njëra rrugë është të luftosh korrupsionin duke hetuar, duke arrestuar dhe duke ndëshkuar personat e përfshirë në të. Kjo kërkon të rriten kompetencat hetimore të policisë dhe të prokurorisë, të forcohen mekanizmat e inspektimit, të kontrollit etj. Kjo rrugë “shtypëse” mbështetet në idenë se korrupsioni është shkëmbim vullnetar i ndërmarrë nga pjesëmarrësit në të, për të realizuar interesat e tyre private. Ajo bazohet edhe në hamendësimin që ata që përgjigjen për kontrollin dhe zbatimin e ligjit (policia, prokuroria, etj.), nuk janë të korruptuar. Por asnjëri prej këtyre hamendësimeve, në vetvete, nuk është i vërtetë, veçanërisht në vendet dhe në institucionet ku korrupsioni është mjaft i përhapur ose mbizotërues.

Rrugë më të ndërlikuara të përballjes me korrupsionin janë ato që synojnë parandalimin e tij. Ato lidhen me ndërtimin dhe forcimin e institucioneve, të sistemeve dhe procedurave të tilla që të jenë të afta, nga njëra anë, të pakësojnë sa të jetë e mundur faktorët dhe stimujt që i shtyjnë njerëzit, që punojnë në to, të përfshihen në korrupsion dhe, nga ana tjetër, të rrisin sa më shumë stimujt që i shtyjnë njerëzit të largohen prej tij. E thënë shkurt, parandalimi i korrupsionit lidhet me qeverisjen e mirë. Megjithatë, fakti i përmendur më sipër, që njerëzit përfshihen në korrupsion të detyruar nga pushtete të caktuara ose nga kultura e favoreve (e ndereve) të ndërsjella, të çon në idenë që qeverisje e mirë nuk do të thotë, thjesht dhe vetëm, të ndërtosh institucione që synojnë të ndihmojnë njerëzit të shmangin korrupsionin për shkak të interesit të tyre privat.

Qeverisja e mirë nënkupton ndërtimin e institucioneve, për të cilat njerëzit që punojnë të ndihen krenarë dhe në të cilat marrja me korrupsion të vlerësohet si diçka e huaj për konceptin e rolit të tyre publik, si shërbëtorë të popullit. Një faktor i rëndësishëm i strategjive parandaluese është kundërshtimi, gjithnjë e më i qëndrueshëm, ndaj korrupsionit prej qytetarëve si përdorues të shërbimeve publike. Kjo kërkon që qytetarëve t’u sigurohet mundësia të njohin, jo vetëm të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, por edhe pasojat që sjell korrupsioni për shoqërinë dhe për ta si individë. Një gjë e tillë do të mund të ishte më e efektshme, nëse do të ishte pjesë e një politike më të gjerë, që krahas synimit për krijimin e një qytetarie të mirë, do të kishte si objektiv, veçanërisht në fushën e arsimit, që nxënësit të dalin nga shkolla me bindjen se kundërshtimi i korrupsionit shkon përtej interesit të tyre vetjak dhe bazohet në pikëpamjen e përbashkët për tiparet e kësaj lloji qytetarie.

Shkolla mund të luajë një rol themelor në kuadër të politikave kundër korrupsionit. Nga ajo kërkohet të ndihmojë brezat e rinj, nxënësit dhe studentët, për t’u bërë të aftë të përballojnë, me vullnet dhe sukses, trysnitë që i shtyjnë ata në pranimin e ryshfeteve, duke u përfshirë në praktika korruptive. Njohja me të drejtat dhe interesat e tyre, i pajis nxënësit me aftësinë dhe pushtetin për të përballuar trysninë e dhënies dhe marrjes së ryshfeteve, edhe nëse kjo, në pamje të parë, duket në interes të tyre. Po kështu, ideja se qytetarët i kanë këto njohuri, i frenon zyrtarët të kërkojnë ryshfete. Më tej, nëse qytetarët (dhe zyrtarët), si rrjedhojë e arsimit të tyre, janë mësuar të vlerësojnë ryshfetin dhe praktika të ngjashme me të si të papajtueshme me rolin e tyre publik, si qytetarë ose zyrtarë, ata kthehen në pengesa të pakapërcyeshme kundër korrupsionit. Edukimi

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

kundër korrupsionit mund të luajë një rol vendimtar edhe në përpjekjet për të ulur shpeshtësinë e kësaj dukurie tejet dëmtuese për shoqërinë.

## **4. Besimi publik në sistemin e drejtësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

### **4.1. Denoncimi dhe hetimi penal i rasteve**

Sipas ligjit të Procedurës Penale, prokuroria është organi i ndjekjes penale për veprat penale sipas detyrës zyrtare. Fillimi i procedurës penale për veprat penale të korrupsionit është kompetencë e këtij organi. Suksesi i parandalimit dhe ndëshkimit të korrupsionit është i lidhur ngushtë me mënyrën e funksionimit dhe efektivitetin e tij. Kallëzimi penal për një vepër penale të korrupsionit duhet të bëhet deri te prokuroria publike.

#### **4.1.1. Pozita dhe kompetencat e Prokurorisë Publike**

##### **4.1.1.1. Pozita**

Prokuroria publike është organ i vetëm shtetëror i pavarur që i ndjek autorët e veprave penale dhe të tjera të dënueshme sipas ligjit dhe ushtron veprime të tjera të përcaktuara me ligj. Funksionin e prokurorisë publike e ushtron Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë, Prokurori publik i Prokurorisë së lartë publike dhe prokurori publik i prokurorisë themelore publike. Prokurorin publik e emëron dhe e shkarkon Kuvendi i RM-së për një kohë prej 6 vjetëve. Kuvendi i RM-së e shpall emërimin e prokurorit publik në shtypin ditar më së voni 15 ditë nga dita e mbetjes vakand të vendit të prokurorit publik. Me shpalljen, njoftohen kandidatët e interesuar në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes, të paraqesin fletëkonkurimin në Kuvendin e RM-së. Kuvendi i RM-së bën emërimin e prokurorit publik me propozim të Qeverisë. Prokurori publik shkarkohet:

- kur këtë vetë e kërkon;
- kur përgjithmonë e humb aftësinë psikofizike për ushtrimin e funksionit;
- kur do t'i plotësojë kushtet e pensionimit sipas moshës;
- kur është dënuar për vepër penale të burgosjes pa kusht më së paku 6 muaj;
- kur vërtetohet se ka bërë shkelje të rëndë disiplinore të funksionit të prokurorit publik të vërtetuar me ligj, me çka ka dëmtuar autoritetin e funksionit;
- kur joprofesionalisht dhe në mënyrë të pandërgjegjshme ushtron funksionin në prokurorinë publike, që e vërteton Qeveria e RM-së.

Kuvendi i RM-së, me propozim të Qeverisë së RM-së, ngre procedurë për shkarkimin e prokurorit publik kur do të vërtetohet se është plotësuar një nga kushtet e shkarkimit të tij.

Prokurori publik gëzon imunitet. Për imunitetin e tij vendos Kuvendi. Imuniteti i prokurorit publik konsiston në atë që ai nuk mund të merret në përgjegjësi ose të arrestohet për mendimin e shprehur gjatë ushtrimit të funksionit. Prokurori publik nuk mund të arrestohet pa autorizimin e Kuvendit të RM-së, përveç nëse është kapur në kryerjen e veprës penale për të cilën parashihet dënim me burgim më së paku 5 vjet.

Prokurori publik ka edhe disa të drejta të veçanta, siç janë:

- e drejta për të hyrë dhe për të pasur qasje të lirë në stacione;
- aeroporte;
- porte;
- vetëm me kallëzimin e dokumenteve të identifikimit;
- e drejta e mbrojtjes së veçantë të personalitetit të tij, të familjes dhe pasurisë, me kërkesën e tij drejtuar policisë në vendbanimin, gjithmonë kur për këtë ekzistojnë arsye serioze për sigurinë e tij etj.

Prokurori publik është i detyruar të ruajë autoritetin e funksionit që ushtron. Funkzioni i tij është inkompatibil me funksionim tjetër publik dhe profesionim ose me anëtarësimin në parti politike. Prokurori publik, në lidhje me funksionin e tij, nuk guxon të pranojë dhurata nga palët ose persona të cilët në mënyrë direkte ose indirekte kanë interes në procedimin e hetuesisë publike.<sup>47</sup>

#### **4.1.1.2. Kompetenca**

Prokuroria publike e ushtron funksionin e saj mbi bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjit. Sipas Ligjit për prokurorinë publike, prokurori publik dhe zëvendësprokurorët publikë kujdesen për zbulimin efikas dhe në kohë të veprave penale dhe të veprave të tjera të dënueshme dhe të autorëve të tyre, deponojnë kërkesë për ngritjen e procedurës penale dhe të procedurës për vepra të tjera të dënueshme dhe në kuadër të ligjit ndërmarrin masa dhe aktivitete për drejtimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme të procedurës, ngrejnë dhe përfaqësojnë aktakuzën, deklarojnë mjete të zakonshme dhe të jashtëzakonshme juridike dhe ndërmarrin veprime të tjera të përcaktuara me ligj. Për realizimin e funksionit të ndjekjes, prokuroria publike, në bashkëpunim me organet e zbulimit dhe me organet e tjera kompetente dhe me personat e tjerë

<sup>47</sup> [http://aa.mk/wBStorage/Files/poglavje11\\_AL.pdf](http://aa.mk/wBStorage/Files/poglavje11_AL.pdf)

juridikë, kujdeset për marrjen e masave dhe aktivitetëve të tjera për zbulimin e veprave penale dhe veprave të tjera të dënueshme dhe kapjen e autorëve të tyre. Për veprimtarinë dhe detyrat nga kompetenca e saj dhe për ndërmarrjen e aktivitetëve për të cilat është e autorizuar, prokuroria publike pranon denoncime, parashtrësia dhe ankesa të tjera dhe deklarata nga qytetarët, organet e tjera dhe personat e tjerë juridikë.<sup>48</sup>

Në nenin 273 të ligjit për procedurë penale thuhet<sup>49</sup> se të gjithë organet shtetërore, ndërmarrjet publike dhe institucionet janë të obliguar që t’i paraqesin veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, që janë raportuar apo zbuluar në ndonjë mënyrë tjetër. Në bazë të të njëjtit nen paragrafi i tretë parasheh se çdokush mund të paraqesë një vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, se edhe qytetarët duhet t’i tregojnë veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare dhe e kanë për detyrë ta bëjnë këtë se mos kallëzimi i përgaditjes së veprës penale (neni 363 i Kodit Penal të RM) (atëherë kur është në njohuri se personi zyrtarë kërkon ryshfet) dhe moskallëzimi i veprave penale apo mos kallëzimi i kryesisit të saj (neni 364 i Kodit Penal të RM)( atëherë kur personi është në njohuri se ndonjë person zyrtar është përfshirë në veprime korruptive) paraqesin vepra penale.

Poashtu neni 282 obligon Ministrinë e Punëve të Mbrendëshme që pas marrjes së kallëzimit penal apo vënies në njohuri se ekzistojnë shkaqet për dyshimin se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia pa vonesë duhet ta informojë me shkrim prokurorin publik.

Në bazë të nenit 291,292<sup>50</sup>, pas pranimit të kallëzimit penal nga prokurori public në bazë të besueshmërisë ai varësisht nga situatë mund të vendos: ta hedhë poshtë kallëzimin penal, të kërkon informacionë plotësuese, i paraqet propozim gjyqtarit hetues për pëlqimin që të ngihet aktakuzë direkte dhe paraqet kërkesë për zbatimin e hetimit gjyqtarit hetues.

Hetimi zbatohet kundër personit konkret kur ekziston dyshimi i bazuar së është kryer vepër penale. Në fazën e hetimit mblidhen provat dhe të dhënat që janë të nevojshme për të vendosur a do të ngrihet aktakuza ose do të pushohet procedura.<sup>51</sup>

---

<sup>48</sup> Po aty

<sup>49</sup> Gazeta zyrtare nr.150/2010

<sup>50</sup> Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare nr.150/2010

<sup>51</sup> Ejup Sahiti&Ismail Zendeli, fq.126

## **5. Disa raste konkrete të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë për periudhën kohore 2010-2018**

**Rasti “Perandoria”** u hap nga PPS-ja më 8 nëntor të vitit 2018, ku të dyshuar ishin Orce Kamçev, Sasho Mijallkov si dhe dhjetëra persona të tjerë, nën dyshim se kanë larë 8 milion euro, para nga vendi dhe 2.5 milion euro nga vendet e huaja, me çka e kanë dëmtuar buxhetin shtetëror për rreth 6.3 milion euro.

Gjykata solli vendim për shqiptimin e masës së përkohshme për ngrirjen e një pjese të pronës së kompanive të Orka Holding dhe Eksiko si dhe ndalimin e qarkullimit të parave nga llogaritë bankare. Dhe pas kësaj filloi seriali i shkuarjes në paraburgim, lëshimi në paraburgim shtëpiak dhe më pas kthim të pasaportës.

Së pari gjykata dhe PPS nuk e pranuan garancinë prej 14 milion eurove që Kamçev e ofroi që në vend të paraburgimit në burg t’i shqiptohet paraburgim shtëpiak. Por vetëm pas dy javëve, kah fundi i dhjetorit të vitit të kaluar, PPS kërkoi që të gjithëve të paraburgosurve në këtë rast, masa e paraburgimit tu zëvendësohet me paraburgim shtëpiak, gjë që shkaktoi reagime të shumta në opinion. Në atë kohë, Janeva në intervistë për televizionin Kanal 5, këtë kërkesë të PPS-së e arsyetoi me atë se janë mbledhur të gjitha provat e nevojshme për rastin dhe se kjo është e mirë për reformat.

**“Mendoj se në periudhën që ishin në paraburgim janë mbledhur mjaftueshëm prova dhe u analizuan të gjitha aspektet në lidhje me atë se a duhet dhe deri kur do të munden të jenë në paraburgim dhe se a mundet me ndonjë masë tjetër të sigurohet prezenca e tyre. Vlerësojmë se kjo është mirë për reformat dhe për sundimin e së drejtës, që këto persona periudhën e ardhshme të jenë në paraburgim shtëpiak”, thoshte Janeva.**

Megjithatë, incizimi që u publikua së fundmi tregon se përputhen datat e ngjarjeve më pas. Dorëzimi i parave mes Kamçevit dhe Bokit 13 ka ndodhur më 20 janar, ndërsa më 4 mars Gjykata Supreme solli vendim që Kamçev të mbrohet nga liria. Pas 8 ditëve, përkatësisht më 12 mars, rastësisht apo jo kishte vërshime në PPS, ku kishte dyshime për përpjekje për shkatërrim të provave të rastit “Perandoria”. Por burime nga PPS për TV21 pohojnë se asgjë nuk është dëmtuar dhe se vetë prokurorja Lile Stefanovska me një pjesë të të punësuarve ka hyrë në hapësirat e vërshuara dhe i kanë nxjerrë materialet. Momenti që gjithashtu e befasoi opinionin është ajo që në qershor Kamçev morri pjesë në finalen e ndeshjes së hendbollit në Keln, ku

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

luante reprezentacioni i Maqedonisë. Kamçev shkoi në Gjermani pasi që PPS ka pranuar që t'i kthehet pasaporta, ndërsa Janeva këtë e arsyetoi se i nevojitet për edukim dhe vazhdim të biznesit.

**“Nuk do të doja të jem avokatja e z. Orce Kamçevit, në aspekt që ta mbroj. Vlerësuam se është e nevojshme që t'i jepet pasaporta për shkak se hetimi në pjesën e mbledhjes së dokumentacionit financiar ka mbaruar dhe po analizohet në këto momente”, deklaroi Janeva më 05.06.2019.**

**Rasti “Reket”** përsëri u hap pas publikimit të incizimit ku Boki 13 dhe Goran Milevski i kërkojnë 8 milion euro Orce Kamçevit, që, siç i është thënë, të ndikojnë te një prokuror për rastin “Perandoria”, me çka të dyve iu është shqiptuar masë paraburgimi.

Derisa Resul Lloga dhe Ardian Amzoski nga Drim Biding janë të dëmtuar nga marrëveshja që kanë lidh me “Lidhjen Ndërkombëtare” të Boki 13 duke paguar 260.000 euro.<sup>52</sup>

**Akuza e dosjes “Titanik”**, ka të bëjë me parregullsitë e shënuara gjatë zgjedhjeve të fundit, dëmtim të së drejtës së votimit, blerjen e votave, dëmtimin e materialit zgjedhor dhe keqpërdorimin e mjeteve financiare për financim të fushatës zgjedhore.<sup>53</sup>

Paraditen e sotme në seancën e sotme gjyqësore të rastit “Titanik” janë treguar fletëpagesa të skanuara PP-10 nga persona fizik, që ishin donacion nga VMRO-DPMNE në shumta prej gjashtë deri 60 mijë denarë, transmeton Portalb.mk.

Prokurorja e PSP-së, Lile Stefanovska theksoi se ata janë paguar në disa data të njëjta që përsëriten edhe atë në sportelin e njëjtë nga personi i njëjtë, për të cilën kanë edhe dëshmitarë që e konfirmojnë, si dhe disa fletëpagesa kanë emra të gabuar, ndërsa numra të saktë amë. Në fillim të seancës janë treguar materiale dëshmi. Prokurorja Stefanovska theksoi se ka rreth 5.900 materiale dëshmi dhe që me mbrojtja pajtohet që dëshmitë të tregohen në ekran, dhe të lexohen vetëm numrat rendorë nën të cilat janë dorëzuar Stefanovska theksoi se grupi i parë i dëshmive ka të bëjë me shoqërimin kriminel dhe veprimet e ndërmarra në vitin 2011. Ajo shpjegoi se bëhet fjalë për keqpërdorimin e mjeteve në fushatë zgjedhore.<sup>54</sup>

<sup>52</sup> <https://www.alsat-m.tv/reket-deshmojne-biznesmenet-e-zhvatur-nga-boki-13/>

<sup>53</sup> <https://portalb.mk/243751-titanik-jankullovska-sot-ne-gjykaten-themelore/>

<sup>54</sup> <https://portalb.mk/578183-ne-rastin-titanik-jane-treguar-fletepagesa-me-donacione-nga-vmro-dpmn/>



“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

Rasti “**Trajektorja**”, në të cilën ish-kryeministri Nikolla Gruevski është i akuzuari kryesor por dhe ish-zëvendëskryeministri Vladimir Peshevski, ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve Mile Janakievski dhe ish-drejtori i Agjencisë për rrugë shtetërore, Lupço Georgievski.

Ata dyshohen se në gjysmën e dytë të vitit 2012 dhe gjatë vitit 2013 kanë marrë shumë veprime me të cilat në procedurën për përzgjedhjen e kompanisë për ndërtimin e autostradës Miladinovci – Shtip dhe Kërçovë – Ohër i kanë shfrytëzuar dhe i kanë tejkaluar autorizimet.

Me këtë, sipas aktakuzës së PSP-së, e kanë dëmtuar buxhetin e shtetit prej të paktën 155 milionë euro dhe për të njëjtën vlerë, kompanisë realizuese i kanë mundësuar të përfitojë dobi pronësore.

“**Shkupi 2014**” është projektuar në vitet 2005-2006 dhe kishte si qëllim që përmes ngritjes së përmendoreve, të forcoj identitetin kombëtar maqedonas sikur edhe përmes fasadave të ndërtesave në stilin barok, porekspertët dhe njohësit e çështjeve politike thonë se projekti tashmë ka treguar efekt të kundërt, duke rritur përçarjet në shoqëri, duke tensionuar marrëdhëniet me shtetet fqinje, si dhe duke rritur kritikën si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë, për afëra të shumta korruptive që vazhdojnë ta përcjellin këtë projekt kundërthënës. Në një demokraci të qëndrueshme me një ekonomi të shëndoshë korrupsioni mund të shkaktojë dëme të mëdha. Në një demokraci të "brishtë" si ajo në Maqedoni efektet e tij janë edhe më të rënda. Por ndërsa media ka shfaqur shumë raste korruptive ku kanë qenë të përfshirë zyrtarë të lartë të partive dhe të shtetit, autoritetet janë treguar të ngadalta për të pranuar shkallën e problemit dhe për të ndërmarrë hapa konkretë në luftën ndaj tij. Një fushë e gjerë për korrupsion është shfaqur gjatë transformimit të ekonomisë publike maqedonase në pronësi private, nëpërmjet punës së komisioneve të ndryshme, shpërndarjes së investimeve të huaja e kredive dhe tani së fundi në dhënieve e pensione të invaliditetit. Kriza e Kosovës ka qenë një mundësi tjetër për korrupsion, ndërsa disa policë dhe punonjës humanitarë thuhet të kenë kërkuar rrushfete për të strehuar refugjatët nëpër kampe, apo për të rregulluar evakuimin e tyre për në vende të tjera. Ministria e brendshme ka konfirmuar së fundi se korrupsioni në Maqedoni është shtrirë në rradhët e drejtorëve të kompanive, zyrtarëve të doganave, inspektorëve të taksave, arbitrave të futbollit, doktorëve dhe deri mësuesve. Por departamenti anti-korrupsion i ministrisë ka zbuluar deri më tani vetëm 147 raste gjate tre vjetë e gjysëm të fundit, ku kanë qenë të përfshirë 170 të dyshuar. Kjo përbën 0.6 -1.3 përqind të krimeve të përgjithshme në Maqedoni, ose 13-30 përqind të krimet ekonomik. Policia maqedonase argumenton se kushtetuta nuk lejon përgjimin dhe filmimin e fshehtë, taktika të cilët, sipas tyre, duhet të përdoren me qëllim që të mblidhen prova ndaj

figurave të rëndësishme të qarqeve të politikës dhe financës. Nga 1,056 akuza të lidhura me korrupsionin që policia ka ngritur ndaj zyrtarëve gjatë tre vjetëve të kaluar, 64 përqind nuk janë pranuar për mungesë provash. Dhe më pak se një e treta e atyre që kanë shkuar në gjykatë janë dënuar. Vitin e kaluar takimet e Paktit të Stabilitetit në Ballkan të organizuara në Sarajevë, Gjenevë, Bari dhe Oslo janë marrë kryesisht me çështjen e korrupsionit në Europën juglindore, e cila është konsideruar jo vetëm si një faktor destabiliteti për institucionet demokratike dhe një kërcënim direkt për të drejtat dhe liritë e njeriut, por edhe një sfidë direkte për vetë Paktin e Stabilitetit. Si rrjedhojë, qeveria maqedonase u inkurajua të nënshkruajë të gjitha konventat ndërkombëtare ekzistuese kundër korrupsionit dhe të ndërmarrë masat e saj. Por përsëri, ashtu si edhe qeveria e mëparshme, kjo administratë ka treguar pak dëshirë për ta luftuar këtë problem. Ligjet anti-korrupsion nuk do të miratohen përpara muajit dhjetor, sepse, sipas kryeministrit, qeveria ka probleme më të rëndësishme për të zgjidhur më parë. Mungesa e një legjislacioni konkret nuk është i vetmi problem. Mungesa e koordinimit të punës ndërmjet policisë, prokurorisë dhe disa inspektoriateve të ndryshme të krijuara për këtë qëllim e ka lehtësuar shtrirjen e krimit të organizuar. Në emër të efikasitetit, kryetari i parlamentit Savo Klimovski i ka bërë thirrje prokurorit të përgjithëshëm Stavre Giokov të mos marrë hapa ndaj zyrtarëve të cilët janë përmendur nga raporte të ndryshme të paraqitura nga disa ministri të ndryshme. Në të njëjtën kohë, Klimovski ka lënë të kuptohet edhe për një rezistencë ndaj përpjekjeve anti-korrupsion nga rradhët e "disa strukturave të autoriteteve të tanishme, të cilat janë të përfshira edhe vetë në krime." Kryeministri maqedonas Lubço Georgievski dhe koalicioni "Për Ndryshim" janë zgjedhur pas premtimeve se do të luftojnë krimin e organizuar. Si rrjedhojë edhe puna e tyre e deritanishme është vënë nën vëzhgim. Gjatë dy vjetëve të kaluar, qeveria ka ndërmarrë hetime të cilat kanë rezultuar në akuza ndaj zyrtarëve të lartë të administratës së mëparshme. Partitë e opozitës i kanë quajtur këto raste si "hakmarrje politike", por tani kryeministri po përqëndrohet në partinë e tij. "Ne kemi dokumenta dhe prova konkrete se disa njerëz nga rradhët e VMRO-DPMNE janë të përfshirë në krime," ka thënë ai. "Unë nuk do t'i toleroj këto sjellje dhe as nuk kam ndërmend të rrezikoj popullaritetin e partisë sime për këta njerëz." Natyrisht kjo nuk është deklarata e parë për luftë kundër krimit të organizuar. Ish-kryeministri dhe drejtuesi i LSDM-së, Branko Cërvenkovski, ka premtuar më parë të shkatërrojë "oktapodin" e korrupsionit, por ai jo vetëm që ka dështuar të ketë ndonjë progres në këtë fushë, por edhe humbi pushtetin shumë shpejt. Mbetet për t'u parë nëse kryeministri i tanishëm do të ketë më tepër sukses ndaj një

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

"sistemi paralel" që është krijuar tashmë dhe në mënyrë të ngadaltë, por të vazhdueshme, po rrezikon edhe vetë bazat e shoqërisë maqedonase.<sup>55</sup>

---

<sup>55</sup> <https://iwpr.net/sq/global-voices/maqedonia-e-perfshire-nga-korrupsioni>

## 6. Cikli i jetës së mekanizmave të raportimin të korrupsionit

Institucionet shtetërore në Maqedoni përdorin dy mënyra themelore për raportimin e korrupsionit. Institucionet themelore në sektorët me rrezik lartë të tilla si kujdesi shëndetësor dhe inspektoratet kanë linja të veçanta telefonike për raportimin anonim të korrupsionit. Këto institucione përfshijnë Ministrinë e Punëve të Brendshme, Universiteti në Shkup, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria tatimore, Drejtoria doganore etj. Shumë institucione të tjera kanë zhvilluar sistemin e raportimit elektronik përmes të cilit përdoruesit e internetit mund të raportojnë korrupsionin duke plotësuar formularin elektronik. Këto institucione duhet të përpunojë këto ankesa dhe në fund të fundit të përballen me korrupsionin me atë që do ti përfaqësojë në prokurorinë publike. Mekanizma të ngjashme elektronike për raportimin e korrupsionit janë vendosur edhe në disa komuna. Mekanizmi më i avancuar teknologjik për raportimin e korrupsionit përdoret në sektorin e OJQ-ve, në zyrën lokale e Transparency International në Shkup. Kjo organizatë mbledh ankesat përmes një formulari elektronik, si dhe nëpërmjet shërbimit të specializuar të internetit “Prijavikorupcija.org”, përmes të cilit njerëzit me smart telefonat e tyre mund të përdorin aplikacionin për regjistrim të ryshfetit dhe korrupsionit. Ky shërbim përdor geolokacion opsional që të mund gjeografikisht të gjej lokacionin e ankesës. Ka një model të caktuar të numrit të ankesave të paraqitura pas krijimit të një mekanizmi për raportim. Në mënyrë tipike, kur mekanizmi është vendosur për herë të parë, ankesat vijnë në numër të madh në mijëra. Megjithatë, autoritetet thonë se shumica e ankesave nuk kanë të bëjnë me korrupsionin, por më shumë për pakënaqësinë me punën e nënpunësve dhe funksionarëve. Në pesë vitet e fundit, numri i ankesave ka rënë dukshëm. Drejtoria doganore ka pasur një reduktim prej 50% në numrin e ankesave nga viti 2010 në vitin 2014 nga 142 në 71 dorëzime. Situata është e ngjashme edhe në institucionet e tjera, në të cilat linjat telefonike të veçanta rrallë apo fare nuk pranojnë ankesa. Për shembull, një raport hulumtues i vitit 2010, Ministria e Punëve të Brendshme refuzoi të zbulojë numrin e ankesave që të "mos dekurajojë qytetarët" për të raportuar korrupsionin në institucione. <sup>1</sup> Shembulli më i dukshëm është Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Komisioni është themeluar si organ qendror i cili duhet të punojë në fushën e parandalimit të korrupsionit. Që nga themelimi i Komisionit, të numri i ankesave është zvogëluar nga 603 në vitin 2003 në 201 në vitin 2013. <sup>2</sup> Përveç kësaj, nuk ka asnjë informacion

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

në dispozicion të publikut në lidhje me numrin e ankesave të paraqitura në institucionet publike në nivel vjetor. Mbajtje e shënimeve rreth ankesave të parashtruara është përgjegjësi e secilit institucion, dhe nuk ka asnjë sistem të centralizuar apo të koordinuar. Shumë institucione nuk kanë publikuar numrin e ankesave, kështu që është shumë e vështirë për tu vlerësuar. Prokuroria Publike vë në dukje se në vitin 2013 ka pasur 1414 raporte të abuzimit të pushtetit dhe vetëm 13 për ryshfet, por është e paqartë se sa prej këtyre ankesave janë pranuar përmes mekanizmave për raportim, si dhe as se sa nga procedurat për shpërdorim të detyrës kanë lidhje me korrupsion. Në mënyrë tipike, autoritetet besojnë se zvogëlimi i numrit të ankesave është për shkak të aktiviteteve të anti-korrupsionit të ndërmarra nga institucionet, përmes të cilave, sipas tyre, reduktimi i korrupsionit është pasojë e dukshme. Megjithatë, ky supozim është i diskutueshëm, dhe në fakt provat indikojnë në gabueshmërisë e saj. Raporti për vlesimin e korrupsionit i vitit 2014, publikuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) ofron një analizë krahasuese të përfshirjes në korrupsion nëpërmjet dy sondazheve të kryera në vitin 2002 dhe 2014. 3 Rezultatet tregojnë se korrupsioni i vogël është në të njëjtin nivel ose ka parë një rritje të lehtë. Pasiqë numri i supozuar i transaksioneve korruptive (ryshfetit ose shërbimit) është i njëjtë, ankesat e dërguara nëpërmjet këtyre mekanizmave për raportimin e korrupsionit duhet të jetë afërsisht në numër të njëjtë. Një shpjegim për numrin e reduktuar të ankesave drejton në ciklin e jetës së këtyre mekanizmave. Rritja e intensiteti të ankesave të paraqitura shënohet në fillimin e aplikimit dhe korrespondojnë me fondet e disponueshme për aktivitetet promovuese. Aplikimi i mekanizmave zakonisht fillon me një fushatë marketingu që forcon profilin publik të iniciativës. Pas shpalljes, viktimat përpiqen të përdorin këtë mekanizëm. Pasi profili publik të zhduket, zvogëlohet edhe numri i ankesave të paraqitura. Ky interpretim mund të mbështetet nga shembulli i ciklit të jetës të “Prijavikorupcija.org” i Transparency International, pavarësisht nga fakti se nisma vjen nga sektori i OJQ-ve. Pasi për here të parë zbatohet nga viti 2012-2013, shërbimi numëroi më shumë ankesa se sa gjatë vitit 2014 dhe gjysma e parë e vitit 2015. 4 Përkundër faktit se shërbimit i internetit është ende aktiv, aktivitetet promovuese janë më pak dhe më pak viktimat të korrupsionit e përdorin këtë mekanizëm.<sup>56</sup>

---

<sup>56</sup> [https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2015/12/images\\_publicacii\\_Imagine-If-You-Were-A-Low-Paid-Clerk-Misha-Popovikj-IDSCS-AL.pdf](https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2015/12/images_publicacii_Imagine-If-You-Were-A-Low-Paid-Clerk-Misha-Popovikj-IDSCS-AL.pdf)

## 7. Mjedisi i korrupsionit

Një tjetër shpjegim për rënie në numrin e raporteve të korrupsionit është përshkak të mjedisit dekurajues e cila nuk është e favorshme për suksesin e këtyre mekanizmave. Ekspertët kanë identifikuar disa faktorë kryesorë që kontribuojnë në suksesin e veprimtarive antikorrupsion, të tilla si liria e medias, numri i organizatave në shoqërinë civile, dhe besimi tek njerëzit (kapitali social).<sup>5</sup> Përderisa të gjitha këto janë të rëndësishme për të kuptuar shkallën e korrupsionit prezent në Maqedoni, ky raport do të fokusohet vetëm në faktorin e fundit, pasi ajo ndikon drejtpërdrejt në shkallën e motivimit tek njerëzit që të paraqesin ankesa. Studimet sugjerojnë nivele të ulëta të besimit tek të huajt.

Vetëm një në dhjetë qytetarë të Maqedonisë, deklarojnë që në përgjithësi mund tu besohet të huajve. 6 Ky është një faktor i rëndësishëm në krijimin e rrjeteve të solidaritetit si pjesë e shoqërisë civile që të mund të veprojnë kundër korrupsionit. Për më tepër, duke pasur parasysh rrethanat e formësimit të një kulture të mosbesimit të përgjithshëm në institucione. Si pasojë, ky dyshim i dekurajon njerëzit të ushtrojnë lidhje me institucionet dhe kontribuon në pozicionimin e tyre si viktimë. Një studim i vitit 2013 për të matur shkallën e besimit në institucionet konfirmon të lartpërmendurën. Më shumë se gjysma e popullsisë nuk i besojnë gjyqësorit dhe rreth 42% nuk i besojnë OJQ-ve. 7 Ky mosbesim në institucionet është themeli i mosefikasitetit të mekanizmave për raportimin e korrupsionit në institucione. E lartpërmendura më tej konfirmohet nga një studim i korrupsionit në sektorin e biznesit, ku 42% e kompanive besojnë se në qoftë se raportojnë korrupsion nuk do të arrijnë asgjë, ndërsa 38% besojnë se në qoftë se raportojnë korrupsion do të kenë pasojë negative. Ky mosbesim në njerëz dhe institucione kufizon fushën e veprimit shoqëror kundër korrupsionit dhe pengon ndjenjën e lidhjes në mes të popullit dhe të institucioneve me çka individët bëhen viktimë të mundshme të korrupsionit. Opinioni publik se institucionet nuk punojnë në interes publik, i tjetëron qytetarët që besojnë se mund të marrin mbrojtje adekuate nga institucionet e tilla. Ndërsa e gjithë kjo përshkruan disponimin e përgjithshëm të qytetarëve ndaj institucioneve në Maqedoni, mjedisi i pamundësueshëm për raportimin e korrupsionit është përkeqësuar më tej nga situata e përgjithshme në vend. Më parë këtë vit, opozita më e madhe politike publikoi biseda telefonike mes funksionerëve të lartë që shfaqin gjendjen e një shteti të kapur. Materialet tregojnë nivel të lartë të korrupsionit në sektorin publik, si dhe kontroll i plotë i partisë politike në degët kryesore të qeverisë (përfshirë

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

gjyqësorin) si dhe ekonomisë. Ka dëshmi për abuzim në kryerjen e prokurimit publik, manipulim elektoral dhe mashtrim. Deri më tani, autoritetet nuk kanë ndërmarrë hapa të mëdhenj nëpër të cilat tregojnë një angazhim për të nisur një hetim për akuzat për korrupsion.

Ky skandal ka demonstruar mosgatishmërinë dhe paaftësinë e institucioneve kompetente, ndërsa njëkohësisht i ka treguar publikut se praktika korruptive mund të kalojë pa u ndëshkuar. Në të njëjtën kohë, ajo krijon një ndjenjë se nuk ka asnjë vlerë në raportimin e korrupsioneve të vogla në rastet kur nivelet më të larta të pushtetit janë edhe më të korruptuara. Pra, shënohet kulmi i perceptimit të gjatë se korrupsioni është i përhapur kudo. Më e rëndësishme, mëson publikun se veprimin shtetëror kundër korrupsionit është i kotë. Kotësia e perceptuar e një veprimi të tillë është një tjetër faktor që dekurajon raportimin e korrupsionit. Kjo mund të shihet edhe në analizën Raportit të vlerësimit të korrupsionit i MCMS dhe aspektet e ndryshme të ndikimit të korrupsionit në publik. Rezultatet tregojnë se publiku është e qetë për sa i përket korrupsionit, i cili do të specifikohet në kapitullin e mëposhtëm në këtë raport. Njerëzit e tolerojnë korrupsionin ose e konsiderojnë të pranueshëm. Për më tepër, është e nevojshme të kryet një analizë për dallimet në mes të grupeve të ndryshme në fushëveprimin. Me atë mund të rrisim të kuptuarit tonë mbi efektin e korrupsionit në shoqëri. Të shqyrtuara bashkë, të tilla aspekte të ndryshme ofrojnë një pasqyrë në mjedisin në të cilin zbatohen aktivitetet anti-korrupsion.<sup>57</sup>

Korruptimi i sektorit publik në Republikën e Maqedonisë është më se e zakonshme. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për vepra serioze penale të kryera nga funksionarët e mëparshëm të lartë, nepotizmin ose ndërkaq dhënia e rregullt e ryshfetit nëpunësve administrativ në procedurat administrative, qytetari i Maqedonisë për çdo ditë ballafaqohet me praktika korruptuese. Ata janë të përhapura deri në atë masë, që tanimë bëhen të zakonshme – rregull, në vend të përjashtimit.

---

<sup>57</sup> [https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2015/12/images\\_publicacii\\_Imagine-If-You-Were-A-Low-Paid-Clerk-Misha-Popovikj-IDSCS-AL.pdf](https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2015/12/images_publicacii_Imagine-If-You-Were-A-Low-Paid-Clerk-Misha-Popovikj-IDSCS-AL.pdf)


## KAPITULLI IV

### **IV. Korrupsioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës 2010-2018**

#### **1. Indeksi i korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën e viteve 2010-2018**

Problemi më i madh me të cilin përballen shoqëritë moderne është më shumë dimension psikologjik sesa social. Kërcënimi i shoqërive moderne është bashkëpunimi i fshehtë i njeriut me krimin e organizuar dhe veçanërisht korrupsionin. Infiltrimi i tepërt në të gjitha pikat e jetës së njerëzve shkakton korrupsionin të shihet përmes një prizmi të ndryshëm - si mjet për të lehtësuar jetën, jo si një e keqe që duhet çrrënjësuar. Qytetarët në korrupsion gjejnë një partner ose një mënyrë më të lehtë dhe më të thjeshtë për t'i arritur qëllimet e tyre dhe kështu filluan të shohin korrupsionin si një mjet dhe jo si një problem që në afat të gjatë kërcënon të shkatërrojë shtetin dhe të gjithë mekanizmat e tij. Në këtë kontekst, lidhet edhe një problem tjetër vjen që nga i lartpërmenduri, që është besimi minimal ose pothuajse jo i qytetarëve në institucionet e shtetit, dhe fajësia për këtë duhet padyshim të adresohet vetëm në një adresë: konfuzioni politik në të cilin gjendet shteti. “Nevoiten ende përpjekje me qëllim që të parandalohet politizimi i shërbimit publik dhe sektorit privat. Përveç parandalimit të dështimit të anijes, Antikorrupsioni ka për qëllim ta bëjë shoqërinë vend më të mirë për jetesë. Nepotizmi në administratën publike vetëm e ngadalëson progresin e shërbimeve publike, por ka edhe pasojave ekonomike”.





### Grafiku 1 Indeksi i korrupsionit për periudhën 2010-2018

Burimi: <https://tradingeconomics.com/macedonia/corruption-index>

Siç mund të shohim nga grafiku indeksi më i lartë i korrupsionit është në vitin 2014, 45, ndërsa më i ulët në vitin 2017, 35.


Komisioni shtetëror për pengimin e korrupsionit është duke përgatitur Strategji pesëvjeçare nacionale për uljen e korrupsionit në vend. Në përpilim do të ndihmojnë disa institucione, organizata dhe ekspertë.

Përkundër përpjekjeve, gjendja faktike tregon që Komisioni kundër korrupsionit ende nuk i posedon hapësirat e premtuara për punë, as nuk është e lidhur në rrjet me institucionet, nga të cilat pritet të marrë të dhënat për punë. Pikërisht, “dembelia” e institucioneve deri më tani është ankesa kryesore e anti- korrupsionit, për të cilën pajtohet edhe pushteti.<sup>58</sup>

<sup>58</sup> <https://telegrafi.com/maqedoni-komisioni-per-antikorrupsion-harton-strategji-kombetare/>


## 2. Shkaqet që kontribuojnë në përhapjen e korrupsionit në vendet në tranzicion, me theks të posaçëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut (rezultate nga anketimi)

Në këtë anketim kemi mostër të rastësishme prej 400 të anketuarve. Më poshtë do të paraqesim grafikë me vendbanimin e personave të anketuar, gjininë dhe shkaqet që ato i lloagarisin si arsye që kontribuojnë në përhapjen e korrupsionit në vendet në tranzicion.




Grafiku 2

Në grafikun numër 2 është paraqitur vendbanimi i personave të cilët kanë marrë pjesë në këtë anketim. 59% e të anketuarve janë nga qyteti dhe 41% prej fshatërave.




Grafiku 3

Në grafikun numër 3 është paraqitur gjinia e të anketurve, prej ku shohim se 62% që kanë marrë pjesë në anketim janë femra dhe 38% meshkuj.



Grafiku 4


Grafiku numër 4 paraqet shkaqet e ekzistimit të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, prej ku mundemi të shohim se 67% e të anketuarve janë përgjigjur se shkak për ekzistimin e korrupsionit është kompetenca profesionale e dobët dhe vetëdija e ulët. 20% e të anketuarve janë përgjigjur se shkak është mungesa e informacionit sesi funksionon sistemi dhe 13% janë përgjigjur se arsye është diçka tjetër.



**Grafiku 5**

Në grafikun numër 5 janë paraqitur format më të përhapura të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në bazë të përgjigjeve të të anketuarve kemi rezultatet e mëposhtme:

- 31% abuzimi me fondet;
- 30% mitëdhënia;
- 15% shantazhi;
- 11% dhuratat;
- 8% përqindjet;
- 5% trajnimi preferencial.




**Grafiku 6**

Në bazë të grafiku numër 6, 63% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë qenë personalisht viktimë e korrupsionit, ndërsa 37% janë përgjigjur se kanë qenë personalisht viktimë e korrupsionit.




### Grafiku 7

Nga grafiku numër 7 shohim se rastet e korrupsionit janë paraqitur vetëm nga 21% e njerëzve të cilët kanë qenë viktimë e korrupsionit, ndërsa 79% nuk i kanë paraqitur.



### Grafiku 8


Nga grafiku numër 8 shohim se 88% e të anketuarve janë përgjigjur se mendojnë që organet kompetente nuk marrin masa për rastet e paraqitura, ndërsa 12% mendojnë që organet kompetente marrin masa për rastet e paraqitura.



**Grafiku 9**

95% të të anketuarve janë përgjigjur se mendojnë që korrupsioni është një nga arsyet e shumta që ky shtet nuk mund të ngrihet, ndërsa 5% mendojnë të kundërtën.

### 3. Lëvizja e korrupsionit në për periudhë 2010-2018 në vendet fqinje në tranzicion në krahasim me Republikën e Maqedonisë së Veriut




**Grafiku 10**

Burimi: <https://tradingeconomics.com/macedonia/corruption-index>

Siç mund të shihet nga grafiku Republika e Maqedonisë së Veriut nga viti 2010-2015 ka pasur indeks më të lartë të korrupsionit, në krahasim me Kosovën. Mirëpo, nga viti 2016-2018 Kosova shënon korrupsion më të lartë se Maqedonia.

Ineks më të lartë të korrupsionit Republika e Maqedonisë ka në vitin 2014 (45), ndërsa indeks më të ulët në vitin 2017 (35). Ndërsa, Kosova indeks më të lartë ka në vitin 2017 (45) dhe indeks më të ulët në vitin 2010 (23).






### Grafiku 11

Burimi: <https://tradingeconomics.com/macedonia/corruption-index>

Siç mund të shihet nga grafiku Republika e Maqedonisë së Veriut në raport me Republikën e Shqipërisë kanë pasur më tepër ndryshime periudhë pas periudhe.


Indeks më të lartë të korrupsionit Republika e Maqedonisë ka në vitin 2014 (45), ndërsa indeks më të ulët në vitin 2017 (35). Ndërsa, Republika e Shqipërisë indeks më të lartë ka në vitin 2018 (45) dhe indeks më të ulët në vitin 2015 (23).



**Grafiku 12**

Burimi: <https://tradingeconomics.com/macedonia/corruption-index>


Ineks më të lartë të korrupsionit Republika e Maqedonisë ka në vitin 2014 (45), ndërsa indeks më të ulët në vitin 2017 (35). Ndërsa, Bosnja dhe Hercegovina indeks më të lartë kanë në vitin 2012 (45) dhe indeks më të ulët në vitin 2011 (23).



**Grafiku 13**

Burimi: <https://tradingeconomics.com/macedonia/corruption-index>

Ineks më të lartë të korrupsionit Republika e Maqedonisë ka në vitin 2014 (45), ndërsa indeks më të ulët në vitin 2017 (35). Ndërsa, Greqia indeks më të lartë ka në vitin 2017 (48) dhe indeks më të ulët në vitin 2011 (34).



**Grafiku 14**

Burimi: <https://tradingeconomics.com/macedonia/corruption-index>

Indeks më të lartë të korrupsionit Republika e Maqedonisë ka në vitin 2014 (45), ndërsa indeks më të ulët në vitin 2017 (35). Ndërsa, Sërbia indeks më të lartë ka në vitin 2016 (45) dhe indeks më të ulët në vitin 2011 (23).

Mirëpo, Republika e Maqedonisë së Veriut në krahasim me këto vende në tri vitet e fundit shënon nivel më të ulët të indeksit të korrupsionin. Kjo gjendje e tri vitetve të fundit në krahasim me vendet fqinje është positive, mirëpo në krahasim me veten duhet të merren masa për uljen e këtij indeksi në nivel shtetëror.

Shkalla e korrupsionit ndër shtete vlerësohet nëpërmjet të dhënave të drejtpërdrejta apo edhe të tërthorta. Të dhëna më të besueshme për korrupsion janë të dhënat nga statistikat e ndryshme policore. Këto të dhëna janë të bazuara në ankesat dhe dënimet zyrtare për korrupsion. Gjithsesi të dhënat faktike vazhdojnë të jenë të vështira për tu mbledhur pakicë numri i kallëzimeve penale nuk pasqyron nivelet aktuale të korrupsionit por cilësinë e prokurorëve. Pra korrupsioni është sfidë e pavarësisë dhe profesionalizmit të gjyqësorit, por edhe e Qeverisë, Parlamentit si dhe institucioneve tjera të administratës publike duke mos lënë anash as mediet dhe shoqërinë civile. Për këtë arsye për të arritur rezultatin e plot për ekzistimin e korrupsionit brenda shtetit,

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti

zhvillohen metoda të ndryshme hulumtimi siç është edhe ajo e anketimit të qytetarëve përmes pyetësorëve zyrtar shtetëror. Sot treguesi më i saktë i rritjes së korrupsionit në botë është [Organizata joqeveritare ndërkombëtare IKP \(Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit\)](#). Përmban sondazhe nga burime të besueshme duke përdor struktura të ndryshme statistikor që bazohen në të dhënat të cilat merren nga të anketuarit, me të dhëna për punëdhënësit, pastaj, nga analistë të ndryshëm si dhe publiku i gjerë. Para se të bëhen publike të dhënat për korrupsion, mbledhen të dhëna tjera shtesë nga institucione të pavarura shtetërore për tre vite me radhë.

## Konkluzioni

Ky punim u realizua në bazë të këtyre hipotezave:

*Hipoteza 0 ( $H_0$ ):* Politikat dhe strategjitë shtetërore të Republikës së Maqedonisë kundër korrupsionit kanë ndikuar në uljen e tij;

*Hipoteza A ( $H_A$ ):* Politikat dhe strategjitë shtetërore të Republikës së Maqedonisë kundër korrupsionit nuk kanë ndikuar në uljen e tij

Hipoteza 0 apo bazë bie poshtë dhe pranohet ajo alternative, sepse Maqedonia ende përballet me fenomenin e quajtur korrupsion në një masë me rrenjë shumë të thella dhe institucionet përkatëse ende nuk i plotësojnë kushtet që masat e ndërmarra të ndikojnë dukshëm në uljen e korrupsionit.

Ky punim paraqet kontribut të veçantë për disa aspekte:

- Së pari, do mund të shfrytëzohet si bazë e mirë e të dhënave për studentët dhe qytetarët;
- Së dyti, do të paraqet mundësi për analizë dhe studim për studentët si edhe njohje për qytetarët;
- Së treti, punimi mund t’u shërbej institucioneve përgjegjëse që janë në luftë me korrupsionin , pra do t’i orientoj kah objektivi korrupsion.

## Rekomandimet

- **Rritja e transparencës nga ana e institucioneve:**
  1. Gjykata të krijojë një databazë me të gjitha gjykimet e realizuara të cilat lidhen me korrupsionin, për të cilat është marrë vendim nga gjykata. Ky dokument të jetë në web-faqen e gjykatës ku të gjithë do të kenë qasje;
  2. Ministria për punë të brendshme: të ketë të publikuara të gjitha rastet që lidhen me korrupsionin;
  3. Komisioni për parandalimin e korrupsionit, të publikojë të dhënat për çështjen e lartpërmendur në atë mënyrë që të gjithë të kenë qasje në të dhëna.
- **Qasje më e lehtë në informacione:** Të vendoset një person për komunikim me publikun, në çdo institucion i cili do jetë i gatshëm të japë përgjigje në telefon apo në mënyrë elektronike për çdo çështje që është në interes të tyre.

- **Ulja e nivelit për pagesa me para të gatshme:** në qershor të vitit 2019 niveli i pagesës me para të gatshme ul në 500 euro dhe në fund të vitit 2019 përsëri u rrit në 2000 euro në kundërvlerë të denarit);
- **Komisioni antikorrupsion të realizoj kontroll të vazhdueshme nëpër institucione,** së paku një herë gjatë përfundimit të vitit kalendarik. Nga ky kontroll të përgadisë procesverbale të cilat do të jenë të publikuara në web faqe me qëllim që të gjithë njerëzit të kenë qasje në informacione dhe në këtë formë të rritet besimi tek institucionet;
- **Në strategjinë për antikorrupsion të përfëshihen qytetarët që të japin mendimet e tyre dhe të tregojnë për rastet,** kjo mund të realizohet përmes një platforme online në të cilën poashtu do të kenë mundësi që në mënyrë anonime të denoncojnë rastet eventuale që kanë përjetuar.

## **Përfundim**

Korrupsioni si dukuri paraqitet në të gjitha sferat e jetës shoqërore, edhe pse ditët e sotme ekzistojnë shumë definicione lidhur me korrupsionin dhe vet mos ekzistimi i një definicioni të denjë për korrupsionin e bën atë edhe më të vështirë. Ndërsa sa i përket të tashmes me korrupsion duhet nënkuptuar jo vetëm shpërdorimin e pozitës zyrtare nga nënpunësit publik, por ai i përfshin të gjithë njerëzit që abuzojnë me pozitën e tyre kudo që paraqitet mundësia për të nxjerrë përfitime me rrugë të lehta.

Korrupsioni po minon drejtësinë në shumë pjesë të botës, duke u mohuar viktimave dhe të akuzuarve të drejtën bazë njerëzore për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Korrupsioni është abuzimi me pushtetin për përfitime private.

Është e vështirë të mbitheksohet ndikimi negativ që ka korrupsioni, rast konkret është vendi jonë Maqedonia në një tranzicion të stërzgjatur. Korrupsioni është një e keqe e madhe e kohës sonë. Ai e shfaq fytyrën e tij kudo. Mund të themi se ai ndohet në themelet e të gjithë problemeve, sjell varfërim, mjerim, sëmundje, konflikte, shfrytëzime etj. Gjithashtu, pas analizës së gjendjes së korrupsionit në Republikën e Maqedonisë shohim se korrupsioni në vendin tonë ka rrënjë mjaft të thella.

### **Zgjidhja?**

Zgjidhja shpesh shihet në më shumë transparencë. Megjithatë, edhe pse e domosdoshme, transparenca nuk është e mjaftueshme. Hulumtimet tregojnë se më shumë transparencë jo domosdoshërisht nënkupton më pak korrupsion, sepse në vendet ku korrupsioni është normë, më shumë transparencë thjeshtë nënkupton që t’i bëhet e ditur njerëzve se çfarë janë duke bërë të tjerët. Pa një paradigmë normative, transparenca thjeshtë u tregohet njerëzve sa ryshfet duhet të paguajn ata për të arritur dicka. E dyta, masat antikorrupsion rëndom reduktohen në ligje dhe komisione anti-korrupsion nga politikanët për t’a hequr barrën nga vetja. Institucionet e tilla jodomosdoshmërisht e adresojnë problemin në esencë. Në një shtet ku “cash is king” ligjet thyhen e njerëzit blihen, pra ata janë thjeshtë “peshkaqen pa dhëmbë”. Shtetet në zhvillim janë fatkeqësisht përplot me shembuj të tillë.

Tendenca për t’u involvuar në korrupsion, ashtu siç e thamë edhe më lartë, buron natyrisht kur interesi personal vihet para atij shoqërorë, gjë që është shumë natyrale, dhe përderisa masat anti-korrupsion nuk e adresojnë këtë vetëdije të ulët qytetare ata asnjëherë nuk do të jenë të



mjaftueshme apo të plota për t’ a shfarosur korrupsionin si fenomen. E çka saktësishtë do të duhej bërë, pra?

Përgjigja nuk është e thjeshtë e as e drejtpërdrejtë. Megjithatë, çdo gjë që do t’i kontribuonte ngritjes së vetëdijes së qytetarit se korrupsioni edhe nëse zgjidh një problem instant krijon dyfish probleme në perspektivë, apo se akti korruptiv në vetvete është moralisht gabim. Kjo pra kërkon mbi të gjitha krijimin e një mendësie idealistike dhe bindje se “...për atë nga e cila do të ketë dobi një shoqëri e tërë vlen të rrezikohet komforti individual.” E kjo, besoj unë, mundë të bëhet duke u thirrur në normat që burojnë nga tradita, feja, apo në idealet si kombi e zhvillimi i shtetit. Pra, përveç transparencës, ligjeve e institucioneve të mirëfillta (të domosdoshme, por jo të mjaftueshme), domosdoshmërisht duhet të zhvillohen edhe normat e nevojshme shoqërore anti-korrupsion. Pra, paradigmës së tanishme pozitive t’i shtohet edhe ajo normative, barra për operacionalizimin e të cilës bie jo vetëm mbi shtetin, por edhe mbi çdo institucion tjetër shoqëror.

## **Lista e shkurtesave**

**RMV**-Republika e Maqedonisë Veriore

**RSFJ**- Republika Socialiste Federative Jugosllave

**OSBE**-Organizata e Evropës për bashkëpunim dhe siguri

**TI**-Transparency International

**FMN**-Fondi Monetar Ndërkombëtar

## Lista e grafikoneve

**Grafiku 1.** Indeksi i korrupsionit për periudhën e viteve 2010-2018

**Grafiku 2.** Vendbanimi

**Grafiku 3.** Gjinia

**Grafiku 4.** Shkaqet e ekzistimit të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

**Grafiku 5.** Forma më e përhapur e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

**Grafiku 6.** A keni qenë personalisht viktimë e korrupsionit

**Grafiku 7.** Nëse te pyetja paraprake jeni përgjigjur po, a e keni paraqitur rastin në organet kompetente

**Grafiku 8.** A mendoni se organet kompetente marrin masa për rastet e paraqitura

**Grafiku 9.** A mendoni se korrupsioni është një nga arsyet e shumta që ky shtet nuk mund të ngrihet

**Grafiku 10.** Krahasimi i lëvizjes së indeksit të korrupsionit të Maqedonisë me Kosovën

**Grafiku 11.** Krahasimi i lëvizjes së indeksit të korrupsionit të Maqedonisë me Shqipërinë

**Grafiku 12.** Krahasimi i lëvizjes së indeksit të korrupsionit të Maqedonisë me Bosnjën dhe Hercegovinën

**Grafiku 13.** Krahasimi i lëvizjes së indeksit të korrupsionit të Maqedonisë me Greqinë

**Grafiku 14.** Krahasimi i lëvizjes së indeksit të korrupsionit të Maqedonisë me Sërbinë

## Literatura e shfrytëzuar

1. Monica Masoveci, Tiranë 1994
2. Veselin Vukotic, Beograd 2000
3. Josip Krega, Tiranë 1994
4. Joseph Nye, Tiranë 1994
5. Vetë autori Neni 1-a i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit - teksti i pastruar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 28/02, 04 / 04,126 / 06, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të datës 10.01.2007, 10/08, 161/08)
6. <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/01/Broshure-AntiKorrupsioni.pdf>
7. Vlado Kamboski&Petar Naumovski, Korrupcijata najgolemo opshtesveno zlo i zakana za prav nata drzhava, Shkup 2002
8. Gazeta zyrtare e RMV-së, nr.46/2004
9. Alisabri Shabani, Muhamed Budimilic, përktheu nga kroatishtja prof.Mustafë Reçica, Sarajevë/Prishtinë 2007
10. Vlado Kambovski dhe Petar Naumovski
11. <http://myla.org.mk/wp-content/uploads/2018/01/ALB-brosura-90x140-za-PRINT.pdf>
12. <http://shtetiweb.org/2018/10/31/indikatore-t-e-zbulimit-te/>
13. [https://sq.wikipedia.org/wiki/Korrupsioni\\_n%C3%AB\\_Maqedoni](https://sq.wikipedia.org/wiki/Korrupsioni_n%C3%AB_Maqedoni)
14. Todor Vitlarov, Represija i Prevencija na Korupcijata, Shkup 2006
15. Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.37/96
16. Neni 357 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë
17. Neni 358 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë
18. Neni 3 i Ligjit për Punë të Brendshme i Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 42/2014)
19. IBID
20. Nuredinoska E. Sazdeski M. Gjuzellov, B. Raporti për vlerësimin e korrupsionit.
21. [http://finpol.gov.mk/za\\_upravata.html](http://finpol.gov.mk/za_upravata.html)
22. <https://www.dksk.mk/index.php?id=16>
23. <http://myla.org.mk/wp-content/uploads/2018/01/ALB-brosura-90x140-za-PRINT.pdf>

24. <https://www.almakos.com/organizatat-qytetare-do-ta-monitorojne-punen-e-komisionit-per-parandalimin-e-korrupsionit-ne-maqedoni/>
25. Ligji për ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin, Gazeta zyrtare nr.32/1999
26. [http://www.unicri.it/topics/organized\\_crime\\_corruption/archive/training\\_albania/materials/1999\\_Civil%20Law%20\\_Corruption\\_Convention.pdf](http://www.unicri.it/topics/organized_crime_corruption/archive/training_albania/materials/1999_Civil%20Law%20_Corruption_Convention.pdf)
27. Ligji për ratifikimin e Konventës Civile për Korrupsionit, Gazeta zyrtare nr.13/2002
28. <http://levizjafol.org/wp-content/uploads/2015/09/KONVENTA-E-KOMBEVE-T%C3%8B-BASHKUARA-KUND%C3%8BR-KORRUPSIONIT.pdf>
29. <http://levizjafol.org/wp-content/uploads/2015/09/KONVENTA-E-KOMBEVE-T%C3%8B-BASHKUARA-KUND%C3%8BR-KORRUPSIONIT.pdf>
30. <http://myla.org.mk/wp-content/uploads/2018/01/ALB-brosura-90x140-za-PRINT.pdf>
31. Prona dhe procesi i transformimit dhe i privatizimit
32. Cristi Danilet, Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë, Tiranë 2011
33. [http://www.mod.gov.al/images/PDF/Strategjia\\_Antikorrupsion2015\\_2020.pdf](http://www.mod.gov.al/images/PDF/Strategjia_Antikorrupsion2015_2020.pdf)
34. [http://aa.mk/wBStorage/Files/poglavje11\\_AL.pdf](http://aa.mk/wBStorage/Files/poglavje11_AL.pdf)
35. Gazeta zyrtare nr.150/2010
36. Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare nr.150/2010
37. Ejup Sahiti&Ismail Zendeli
38. <https://www.alsat-m.tv/reket-deshmojne-biznesmenet-e-zhvatur-nga-boki-13/>
39. <https://portalb.mk/243751-titanik-jankullovska-sot-ne-gjykatën-themelore/>
40. <https://portalb.mk/578183-ne-rastin-titanik-jane-treguar-fletpagesa-me-donacione-nga-vmro-dpmn/>
41. <https://iwpr.net/sq/global-voices/macedonia-e-perfshire-nga-korrupsioni>
42. [https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2015/12/images\\_publicacii\\_Imagine-If-You-Were-A-Low-Paid-Clerk-Misha-Popovikj-IDSCS-AL.pdf](https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2015/12/images_publicacii_Imagine-If-You-Were-A-Low-Paid-Clerk-Misha-Popovikj-IDSCS-AL.pdf)
43. [https://pashtriku.beepworld.de/files/kosova\\_2010/mars\\_2010/elifë\\_luzha\\_kashtkorrupsioni\\_31.3.10.htm](https://pashtriku.beepworld.de/files/kosova_2010/mars_2010/elifë_luzha_kashtkorrupsioni_31.3.10.htm)

“Korrupsioni në RM gjatë periudhës kohore 2010-2018 dhe lufta kundër tij”- Arbana Reshiti